



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada – Government*

**Inputi për Raportin e Progresit**

**Shtator 2011**  
**PRISHTINË**

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE.....	2
HYRJE.....	5
<b>1. KRITERET POLITIKE .....</b>	<b>5</b>
<b>1.1. DEMOKRACIA DHE SUNDIMI I LIGJIT .....</b>	<b>ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>
1.1.1. <i>Institucionet</i> .....	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
1.1.2. <i>Parlamenti / Zgjedhjet</i> .....	6
1.1.3. <i>Administrata Publike</i> .....	7
1.1.4. <i>Sistemi gjyqësor</i> .....	7
1.1.5. <i>Politikat Kundër Korrupsionit</i> .....	10
<b>1.2. TË DREJTAT E NJERIUT DHE MBROJTJA E MINORITETEVE.....</b>	<b>11</b>
1.2.1 <i>Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve</i> .....	11
1.2.2. <i>Të drejtat e minoriteteve, të drejtat kulturore dhe mbrojtja e minoriteteve</i> .....	12
<b>1.3 ÇËSHTJET RAJONALE DHE OBLIGIMET NDËRKOMBËTARE .....</b>	<b>13</b>
<b>2.1 FUNKSIONIMI I EKONOMISË SË TREGUT .....</b>	<b>16</b>
2.1.1. <i>Raportimi në lidhje me zhvillimet e fundit ekonomike</i> .....	16
2.1.2. <i>Raporti për politikat monetare dhe fiskale gjatë periudhës raportuese</i> .....	18
2.1.3. <i>Funksionimi i tregjeve të produkteve</i> .....	19
2.1.4. <i>Sektori financiar</i> .....	20
<b>2.2. KAPACITETI PËR TU PËRBALLUR ME PRESIONIN E KONKURENCËS DHE FORCAVE TË TREGUT BRENDA UNIONIT .....</b>	<b>22</b>
2.2.1. <i>Kapitali Njerëzor dhe Fizik</i> .....	22
2.2.2. <i>Reforma dhe liberalizimi i industrive të rrjetit</i> .....	23
2.2.4. <i>Intervenimet e Qeverisë në ekonomi</i> .....	24
<i>Ndërmarrjet e mëdha shtetërore</i> .....	24
2.2.6. <i>Integrimi tregtar</i> .....	25
<b>3.1. TREGU I BRENDSHËM.....</b>	<b>26</b>
3.1.1. <i>Lëvizja e Lirë e Mallrave</i> .....	26
3.1.2. <i>Lëvizja e Lirë e Kapitalit</i> .....	27
3.1.3. <i>Doganat dhe Tatimet</i> .....	27
<i>b. Administrata Tatimore e Kosovës</i> .....	28
3.1.4. <i>Konkurrenca</i> .....	29
3.1.5. <i>Prokurimi Publik</i> .....	29
3.1.6. <i>Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale dhe të Drejtat e Autorit</i> .....	30
3.1.7. <i>Punësimi, Politikat Sociale dhe Shëndetësia</i> .....	31
3.1.8. <i>Arsimi dhe Huluntimi</i> .....	32
<b>3.2. POLITIKAT SEKTORIALE .....</b>	<b>33</b>
3.2.1. <i>Industria dhe NVM-të</i> .....	33
3.2.2. <i>Bujqësia dhe Peshkataria</i> .....	34
3.2.4. <i>Politikat e Transportit</i> .....	36
3.2.5. <i>Energjia</i> .....	38
3.2.6 <i>Shoqëria Informative dhe Media</i> .....	39
3.2.7. <i>Kontrolli Financiar</i> .....	39
<b>3.3. DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA.....</b>	<b>40</b>
3.3.1. <i>Vizat, kufijtë, azili dhe migrimi</i> .....	40
3.3.2. <i>Pastrimi i Parave</i> .....	43
3.3.3. <i>Policia dhe Luftimi i Krimit të Organizuar</i> .....	43
3.3.4. <i>Mbrojtja e të dhënave personale</i> .....	45

## LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil
AAP	Arsimi dhe Aftësimi Profesional
ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
AKB	Aleanca Kosovare e Bizneseve
AKK	Agjencia Kundër Korrupsionit
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
AKMDhP	Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
AMPSK	Agjencia për Menaxhimin e Pasurive të Konfiskuara dhe Sekuestruara
APP	Agjencia për Prokurim Publik
AP	Avokati i Popullit
APIK	Agjencia për Promovimin e Investimeve në Kosovë
ARBK	Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë
ARC	Agjencia e Regjistrimit Civil
ART	Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
AUV	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
BE	Bashkimi Evropian
BNK	Bashkëpunimi Ndër-Kufitar
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
BRE	Burimet e Ripërtërishme të Energjisë
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore ( <i>Central European Free Trade Agreement</i> )
DK	Doganat e Kosovës
DML	Departamenti i Mjekësisë Ligjore
DPI	Departamenti i Pronësisë Intelektuale
ECAA	Hapësira e Përbashkët Evropiane e Aviacionit ( <i>European Common Aviation Area</i> )
ESK	Enti i Statistikave të Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GP	Grupi Punues
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IFES	Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore
IFS	Institucionet Ndërkombëtare Financiare
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
IKAP	Instituti Kosovar për Administratë Publike
IBA	Zonë e rëndësishme e Zogjve ( <i>Important Bird Area</i> )
IPA	Instrumenti për asistencë të Para Anëtarësimit
KBR	Këshilli për Bashkëpunim Rajonal
KE	Komisioni Evropian
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KK	Kuvendi/et Komunal/e
KKK	Korniza e Kurrikulumi të Kosovës
KKDFE	Kompania Kosovare e Distribuimit dhe Furnizimit me Energji Elektrike
KNF	Kualifikimi ndërkombëtarë për funksionalitet

KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KOSTT	Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
LPIS	Sistemi i identifikimit të parcelave të tokës ( <i>Land Parcel Identification System</i> )
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MAP	Ministria e Administratës Publike
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MFSK	Ministria e Forcës dhe Sigurisë
MIE	Ministria e Integritetit Europian
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPF	Monitorimi i Punës së Fëmijëve
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MI	Ministria e Infrastrukturës
NJIF	Njësia e Inteligjencës Financiare
NP	Ndërmarrje Publike
NSH	Ndërmarrje Shoqërore
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OShP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PK	Policia e Kosovës
PKK	Pika e Kalimit Kufitar
PPP	Partneriteti Publiko Privat
PTK	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës
PV	Plani i Veprimit
QAP	Qendra për Aftësim Profesional
QPS	Qendra për Punë Sociale
Projekti RAE	Projekti për Romët, Ashkalit dhe Egjiptasit
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
RKK	Regjistri i Kredive të Kosovës
SMIL	Sistemi i Menaxhimit Informativ të Lëndëve
SKQZ	Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
SHKCAK	Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës
SHKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës

TQNJ	Trafikimi me Qenie Njerëzore
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UA	Udhëzim Administrativ
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZPI	Zyra për Pronësi Industriale
ZRE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë
ZRRUM	Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina

## Hyrje

Ky raport përmban zhvillimet kryesore në Kosovë nga maji 2011 deri në shtator 2011. Qeveria e Republikës së Kosovës ka shprehur gatishmërinë e saj për t'i dorëzuar të dhënat për Raportin e Progresit të Kosovës për Komisionin Evropian, i cili do të publikohet në vjeshtën e këtij viti.

Të dhënat e prezantuara në këtë raport fokusohen në arritjet e bëra karshi:

- zbatimit të reformave;
- zhvillimin e kapaciteteve legjislative dhe administrative;
- sfidave të identifikuara në raportin e progresit të Komisionit Evropian për vitin 2010, dhe
- Zbatimin e prioriteteve të Partneritetit Evropian, përmes Planit të Veprimit për Partneritet Evropian

Struktura e të dhënave korrespondon me Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2010 duke ofruar informata mbi tri fushat në vijim: Kriteret Politike, Kriteret Ekonomike dhe Standardet Evropiane. Raporti gjithashtu është i bazuar në raporte periodike të hartuara nga institucionet e Republikës së Kosovës.

## **1. KRITERET POLITIKE**

### **1.1. Demokracia dhe Sundimi i Ligjit**

#### **1.1.1. Institucionet**

Me qëllim përmirësimin e mbikëqyrjes së Ekzekutivit nga ana e Kuvendit dhe adresimit të sfidës nga raporti i progresit 2010 mbi përmirësimin e rolit mbikëqyrës të Kuvendit mbi Qeverinë, Kuvendi gjegjësisht Komisionet Parlamentare kanë kërkuar dhe kanë pranuar gjithsej 46 raporte me shkrim nga ministritë e ndryshme të linjës dhe 22 raporte nga institucionet e pavarura. Poashtu, Kuvendi i Kosovës ka ftuar Kryeministrin e Kosovës në dy interpelanca, në lidhje me bisedimet Kosovë-Serbi dhe me ndërtimin e autostradës Morinë-Merdar.

Gjithashtu, me 11 prill 2011 Kryesia e Kuvendit të Kosovës me qëllim të ngritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve për të ndjekur punën e Kuvendit ka miratuar Rregulloren për Rendin dhe Qasjen e Mediave dhe të Publikut në Punën e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Gjatë periudhës raportuese, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të Kuvendit janë mbajtur 11 trajnime për zyrtarët e administratës së Kuvendit ku 56 zyrtar kanë vijuar trajnime në temat si : menaxhim të stafit të Kuvendit, legjislacionin evropian, përafrimi i legjislacionit vendor me atë BE-së, marrëdhëniet BE-Kosovë, Hartimi i Planit të Veprimit të Partneritetit Evropian, menaxhimi të ciklit të projekteve, prokurim publik, dhe trajnim për trajnerë, ndërsa është rekrutuar një zyrtar në Divizionin për Standardizim, Harmonizim ligjor, Këshillim Juridik, Hulumtim dhe Bibliotekë.

Gjatë periudhës raportuese janë përmbyllur procedurat e emërimeve për pozita të larta drejtuese duke emëruar e 13 Sekretarëve të Përgjithshëm në këto ministri; MAP, MF, MASHT, MBPZHR, MD, MZHE, MFSK, MKK, MKRS, MMPH, MPB, MPJ dhe MTI, sikurse edhe Kryeshefat ekzekutivë për Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, Agjencinë e Arkivit Shtetëror, Agjencinë e Promovimit të Investimeve, Agjencinë për Mbështetje të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme dhe Agjencinë Kosovare për Standardizim .

Në avancimin e procesit të decentralizimit, Ligji për Bashkëpunim Ndër-komunal është aprovuar në gusht 2011, po ashtu është përfunduar bartja e kompetencave vetanake për komunat e reja, ndërsa pritet bartja e kompetencave të deleguara. Për më tepër ka përfunduar edhe bartja e dokumentacionit nga komuna e Gjilanit në komunën e Parteshit.

MAPL në bashkëpunim me MTI-në dhe MAP-in më 25 maj 2011, kanë Qendrën për Shërbime Qytetare në Mitrovicën e Veriut. Qendra do të shërbejë për regjistrim të OJQ-ve dhe do t'ju ndihmojë qytetarëve për të filluar biznese. Me 14 korrik 2011, MAPL ka kompletuar raportin mbi identifikimin e mospërputhjet ligjore në legjislacionin për qeverisje komunale, i cili është prezantuar para Grupit Ndërministror për Decentralizim.

#### **1.1.2. Parlamenti / Zgjedhjet**

Në drejtim të reformës kushtetuese dhe asaj zgjedhore me 21 prill 2011 është themeluar Komiteti Mbi Reformën Kushtetuese dhe Zgjedhore me mandat të rishikimit të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme dhe ato Lokale si dhe për legjislacionin përkatës. Sipas planit të punës së Komitetit është paraparë që rishikimi i ligjeve zgjedhore të dorëzohet

Kuvendit për miratim deri në kuartalin e parë 2012, ndërsa sa i përket reformës kushtetuese propozimet pritet të dorëzohen deri në fund të 2011

Për më tepër me datë 26 prill 2011, KQZ-ja ka miratuar Rregulloren nr. 16 për Financimin e Subjekteve Politike në pajtim me nenin 23 të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike, KQZ-ja me datë 10 qershor 2011 ka nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi me OSBE-ne dhe IFES-in ( Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore). Gjatë periudhës raportuese KQZ ka rekrutuar tre zyrtarë të lartë në Sekretariat. Gjatë kësaj periudhe 19 zyrtar të KQZ-së dhe SKQZ kanë vijuar trajnime me temat: votimi elektronik, marrëdhënia e punës dhe sistemi i pagave në kontest të standardeve ndërkombëtare dhe ligjit të aplikueshëm në Kosovë, menaxhimi zyrtarë i dokumenteve sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë, shpenzimet e parasë publike, dhe menaxhim të financave publike.

### **1.1.3 Administrata Publike**

Gjatë kësaj periudhe raportuese, MAP ka vazhduar kompletimin e rregulloreve për implementimin e ligjeve bazë të shërbimit civil, ku me 09.06.2011 ka miratuar:

- rregulloren nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil,
- rregulloren nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave,
- rregulloren 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civil

Po ashtu gjatë periudhës raportuese është aprovuar Rregullorja nr. 07/2011 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive.

Në drejtim të implementimit të rishikimeve funksionale me datë 27 korrik Qeveria ka miratuar Planin Zhvillimor Strategjik për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, kurse me datë 10 gusht 2011 ka miratuar Planin Zhvillimor Strategjik për Ministrinë për Komunitete dhe Kthim. Poashtu me 27 korrik 2011, Komisioni Ndërmintrosor për RAP ka miratuar Planet Zhvillimore Strategjike të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural si dhe Ministrisë e Financave. Po ashtu në këtë takim është marrë vendim që DMRAP/MAP të bëjë monitorimin dhe koordinimin në hartimin dhe zbatimin e të gjitha Planeve Zhvillimore Strategjike.

Në periudhën maj - shtator IKAP-i ka identifikuar 10 standarde trajnimi në fushën e aktiviteteve të "standardit të cilësisë së trajnimeve dhe manualit të tyre". Standardet e cilësisë së trajnimit dhe manuali i tyre është punuar me qëllim të vlerësimit dhe identifikimit të standardeve të cilat do të sigurojnë cilësinë e trajnimit gjatë gjithë ciklit të menaxhimit të trajnimit në vlerësim të nevojave dhe trajnimeve si dhe në zhvillim të trajnimeve.

Për më tepër IKAP-i, gjatë periudhës raportuese ka organizuar 16 kurse trajnimi në temat; administratë e përgjithshme, burime njerëzore, buxhet dhe financa, teknologji informative, bashkim evropian dhe çështje komunale, me 347 pjesëmarrës.

### **1.1.4. Sistemi gjyqësor**

Me qëllim të kompletimit të kornizës ligjore për gjyqësorin në Kosovë, me 29 korrik 2011 nga Kuvendi i Kosovës është miratuar Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, i cili është proceduar për dekretim në Presidencë, ndërsa më 31.08.2011 është miratuar Ligji



për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale, Ekstradim dhe Transferim të Personave të Dënuar.

Gjithashtu, drejtim të implementimit të ligjeve kornizë të reformës gjyqësore (Ligji për Gjykatat, Këshillin Gjyqësor, Këshillin Prokurorial dhe Prokuroritë), me 11 shkurt 2011 është themeluar Komisioni Disiplinor si dhe është caktuar kryetari i ri i komisionit. Po ashtu është nxjerrë Rregullorja për procesin e emërimit të prokurorëve (22 shkurt), rregullorja për punën e Komisionit Disiplinor, Rregullorja për caktimin e kriterëve, procedurave për vlerësimin e Performancës së Prokurorëve dhe Prokurorive (29 gusht), Rregullorja për strukturën organizative dhe funksionale të Njësitit për shqyrtimin e performancës së Prokurorëve dhe Prokurorive (21 korrik), si dhe Rregullorja për zgjedhjen e Drejtorit të këtij Njësi. KPK ka miratuar organogramin e zyrës së Prokurorit të Shtetit dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Gjithashtu, në drejtim të kompletimit të kornizës ligjore për sistemin gjyqësor, MD ka vazhduar edhe me miratimin e legjislacionit sekondar për Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe Ligjin për Ndërmjetësim.<sup>1</sup>

Gjatë periudhës raportuese është bërë përzgjedhja e 2 anëtareve të Këshillit të KGJK-së nga ana e gjyqësorit, Poashtu, deri në përfundimin e procedurës së intervistimit, është caktuar ushtruesi i detyrës së drejtorit të sekretariatit të KPK-se. Në procesin e dytë të emërimit për gjyqtarë dhe prokurorë, më 10 gusht 2011 është bërë dekretimi i 5 gjykatësve suprem, ndërsa sa i përket procesit të emërimit të prokurorëve ka përfunduar procesi i intervistimit dhe mbetet shqyrtimi i dosjeve nga anëtarët e Këshillit dhe procedimi i tyre në Presidencë. Ndërsa sa i përket emërimit të gjykatësve dhe prokurorëve të qarkut në muajin gusht do të fillojë intervistimi i kandidatëve. Po ashtu në prill 2011 KPK ka caktuar prokurorë veçantë për çështjet e krimit të organizuar, krimit ekonomik, korrupsionit dhe trafikimit me qenie njerëzore, si dhe prokurorët e veçantë për hetimin e rasteve të korrupsionit në të gjitha prokuroritë e qarkut dhe në prokuroritë komunale.

Në drejtim të reduktimit të lëndëve të vjetra, Këshilli Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me projektin e USAID/ SEAD ka rekrutuar 30 referentë ekzekutivë për ekzekutimin e lëndëve me dokumente autentike, si dhe ka miratuar planin kornizë në bazë të të cilit janë formuar grupet punuese për përpilimin e rregulloreve dhe akteve tjera që dalin nga ligji për gjykatat dhe Strategjia Shtetërore për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra (15 dhjetor 2010). Për më tepër me vendimin e KGJK-së është formuar grupi punues për përcaktimin e normave për kryerjen e lëndëve gjyqësore për gjyqtarë të gjykatave të rregullta dhe gjykatave për kundërvajtje si dhe grupi punues për vlerësimin e punës së gjyqtarëve (15 mars 2011), duke përcaktuar normat bazuar në identifikimin e

---

<sup>1</sup> UA-të për Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale; Udhëzim administrativ për pakot higjienike dhe pakot ushqimore; Udhëzim administrativ për kalimin e kohës në lokalet e veçanta të institucionit korrektues; Udhëzim administrativ për rregullimin e kontrollit të vizitorëve të të burgosur dhe kohëzgjatja e vizitave; Udhëzimi administrativ për organizimin dhe shpërbëlimin për punën e të burgosurve në institucionin korrektues; Udhëzimi administrativ për kompensimin në rast të pa aftësisë në punë; Udhëzimi administrativ për mbajtjen dhe përdorimin e armës; Udhëzim administrativ për përdorimin e forcës, lejimin dhe përdorimin e mjeteve shtrënguese dhe lejimin, përdorimin dhe ruajtjen e armëve të zjarrit; Rregullore e Panelit për Lirim me kusht; Udhëzimin administrativ mbi vazhdimësinë e punës së institucioneve ekzistuese korrektuese në Kosovë dhe themelimin e shoqërive tregtare në institucionet korrektuese; dhe Udhëzim administrativ mbi fshehtësinë e informacioneve, dhënien dhe zbulimin e tyre dhe udhëzime për media. UA-të për Ligjin për Ndërmjetësim: Rregulloren e punës; Kodin e mirësjelljes së ndërmjetësve; Rregulloren për trajnimin dhe certifikimin e ndërmjetësve; Rregulloren për përzgjedhjen e pjesëmarrësve në trajnim për ndërmjetësim; Planin e veprimit për trajnimin e ndërmjetësve; Planin e Programit të Punës dhe Doracakun për trajnimin e ndërmjetësve.

kategorive sipas llojit të lëndëve për të cilat është bërë peshimi i lëndëve nga koha mesatare që gjyqtarët kalojnë duke punuar një lëndë, si dhe përcaktimi i vlerës vjetore të kohës efektive të një gjyqtari duke miratuar Rregulloren për përcaktimin e normave të detyrueshme si dhe Rregulloren për vlerësimin e punës së gjyqtarëve. Po ashtu, në drejtim të reduktimit të ngarkesës për gjykatat, Ministria e Drejtësisë ka funksionalizuar sistemin e ri të noterisë në Kosovë duke bërë licencimin e dhjetë noterëve të parë në Kosovë. Gjithashtu, MD në drejtim të implementimit të Ligjit për Ndërmjetësim ka trajnuar 90 kandidatë për ndërmjetës duke i certifikuar nga Komisioni për Ndërmjetësim, dhe licencuar nga Ministria e Drejtësisë më 29 korrik 2011.

Komisioni disiplinor për gjyqtarë deri më tani ka marrë vendime për 10 gjyqtarë nga gjithsejtë 19 lëndë të proceduara. Nga masat e shqiptuara disiplinore janë 2 raste me qortim dhe 1 rast me qortim me vërejtje, ndërsa për dosje tjera është konstatuar shkelja disiplinore, pasi që personat në fjalë nuk janë pjesë e sistemit gjyqësor nuk janë shqiptuar masa ndaj tyre mirëpo janë iniciuar veprime të mëtutjeshme hetimore në prokurori.

Ndërsa lidhur me trajtimin e masave disiplinore për prokurorë më 27 prill 2011 është themeluar komisioni disiplinor i KPK-së. Numri i rasteve disiplinore të raportuara në këtë komision janë 12, prej të cilave 6 raste janë shqyrtuar me ekzekutimin e masave ndëshkuese me pezullim të procedurës. Ndërsa sa i përket aktiviteteve për menaxhimin e performancës, është përzgjedhur drejtori i njësisë për shqyrtimin e performancës, duke themeluar dhe funksionalizuar njësitin për shqyrtimin e performancës i cili më 1 qershor 2011 ka filluar me vlerësimin e punës së prokurorëve.

Me qëllim të avancimit ligjor të gjyqësorit, gjatë periudhës raportuese KGJK ka organizuar një trajnim për gjyqtarët aktual dhe stafin mbështetës administrativ për përdorimin e SMIL-it duke i trajnuar gjithsej 192 kandidatë.

Përveç kësaj, gjatë periudhës raportuese janë mbajtur trajnime të specializuara në çështjet e korrupsionit, Dëshmitarët në Procedurën Penale, Qasja në databazën e Tribunalit të Hagës për Krimet e Luftës në ish Jugosllavi, Marrëveshja për Pranimin e Fajësisë, Shpronësimi, Vendimet Gjyqësore dhe Veprimet Kadastrale dhe Ligji për Ndërmjetësimin.

Ndërsa në kuadër të programit të trajnimeve për avancim janë organizuar 5 trajnime të ndara në 4 module dhe një trajnim i avancuar për Gjyqtarë Porotë, janë certifikuar gjithsejtë 17 trajnues në fushën e së drejtës së BE-së, prej tyre: 11 gjyqtarë, 3 prokurorë, 2 avokat dhe 1 trajnues i përhershëm në IGJK.

Po ashtu MD ka kompletuar në tërësi njësinë e transportit për të burgosurit, si dhe ka trajnuar stafin në sistemin shëndetësor të burgjeve në aspektin e kujdesit të veçantë në identifikimin dhe trajtimin e përdoruesve të drogave. Në drejtim të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, në maj 2011 është ratifikuar marrëveshja me Turqinë për ndihme të ndërsjellë ligjore, ekstradim, transferim të personave të dënuar në çështje penale, ndërsa janë në përfundim negociatat për marrëveshje bilaterale me Malin e Zi dhe Zvicrën, SHBA, Shqipërinë dhe Slloveninë.

### 1.1.5. Politikat Kundër Korrupsionit

Me qëllim të adresimit të prioriteteve në fushën e politikave kundër korrupsionit më 31.02.2011 është miratuar Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik; Ligji për Përgjegjësinë e Personave Juridik (i miratuar nga Kuvendi më 31.08.2011), Ligji për Mbrojtjen e Informatorëve (i miratuar nga Kuvendi më xxx), Ligji për financimin e subjekteve politike (i miratuar nga Kuvendi më 31.08.2011), dhe ai i Prokurimit Publik (i miratuar nga Kuvendi më 29.08.2011).

Në anën tjetër, për sa i përket luftimit të korrupsionit në gjykatat e Kosovës janë raportuar **216** lëndë të trashëguara nga vitet e mëparshme ndërsa gjatë periudhës raportuese (tetor 2010 – qershor 2011) janë raportuar **92** lëndë, nga totali i të cilave janë zgjidhur **75** lëndë. Gjykatat ndaj këtyre rasteve kanë ndërmarrë këto vendime gjyqësore: 40 lëndë me aktgjykim gjykues, **5** lëndë me Aktgjykim Lirues dhe **29** lëndë në mënyrë tjetër

Gjatë periudhës raportuese, AKK ka filluar procesin e konfirmimit të deklaratave të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, dhe njëkohësisht ka publikuar deklaratat e pasurisë të 1830 zyrtarëve të lartë publik në formën elektronike online në ueb faqen e saj. Poashtu AKK ka iniciuar procedura kundërvajtëse për 84 zyrtarë të lartë publikë që kanë shpërfillur deklarin e pasurisë, ndërsa lidhur me rastet e deklarimit të rremë ka filluar kontroll paraprak për vërtetimin e ekzistimit apo jo të gabimeve materiale dhe plotësimin e saktë të formularit.

Në anën tjetër, për sa i përket luftimit të korrupsionit brenda institucioneve të zbatimit të ligjit, në Inspektoratin Policor të Kosovës, ka hapur 9 raste gjatë periudhës raportuese prej tyre 6 raste presin fillimin e investigimit përderisa 3 janë duke shqiptuar masat ndëshkuese.

Gjithashtu, në Inspektoratin për mbikëqyrjen e punës së Shërbimit Korrektues të Kosovës gjatë periudhës raportuese është raportuar 1 rast i veprimeve të korrupsionit duke shqiptuar masën disiplinore me suspendim nga puna.

Gjatë periudhës raportuese Dogana ka iniciuar 3 raste të korrupsionit brenda strukturës së saj. Paralelisht me këtë, Komisioni Disiplinor i Doganës ka shqyrtuar 1 rast të kësaj natyre duke shqiptuar masën disiplinore të ndalimit të promovimit.

Agjencia kundër Korrupsionit më 12 korrik 2011 ka publikuar raport analizën mbi ndjekjen dhe gjykimet e rasteve korruptive në Kosovë, dhe të dhënat statistikore mbi hetimin dhe gjykimin e veprimeve korruptive. Gjithashtu AKK në kuadër të aktiviteteve sensibilizuese më 13 qershor 2011 ka organizuar punëtori në Zyrën Qendrore të ATK-së për mbështetje në realizimin e veprimit “ngritja e vetëdijes së zyrtarëve të administratës tatimore përmes trajnimeve të specializuara në fushën kundër korrupsionit”. Po ashtu AKK më 15 qershor 2011 në zyrat regionale në Gjilan dhe Ferizaj ka mbajtur tri prezantime në fushën kundër korrupsionit me pjesëmarrjen e 80 zyrtarëve të ATK-së

## **1.2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve**

### **1.2.1 Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve**

Në fushën e të drejtave të njeriut, Kuvendi ka shpallur konkursin për plotësimin e 5 pozitave për Zëvendës të Avokatit të Popullit. Procedura e seleksionimit për zgjedhjen e 5 zëvendësve të AP është përfunduar dhe është dërguar për rekomandim tek Avokati i Popullit.

Në drejtim të adresimit të çështjes së personave të pagjetur, Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 31.08.2011 ka miratuar projektligjin për Personat e Pagjetur. Gjithashtu janë mbajtur trajnime nga ana e ekspertëve të EULEX-it për stafin vendor, në kuadër të DML-së, rreth njohurive bazë të antropologjisë-puna në terren. Është punuar në rreth 13 lokacione, përfshirë këtu edhe 'rastin e Livoçit' dhe 'rastin e Suharekës' (kërkesa të Delegacionit të Beogradit), ndërsa rastet tjera ishin si rezultat i analizimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit dhe të dhënave që institucionet relevante i kanë në dispozicion.

Sa i përket koordinimit të politikave në fushën e të drejtave Pronësore, më datën 13 gusht 2011, Qeveria ka emëruar Koordinatorin e të Drejtave Pronësore, në kuadër të ZKM-së.

Për më tepër, në fazën e plotësim/ndryshimit të Kodit Penal, është eliminuar çështja e mospërputhshmërisë ndërmjet Ligjit për Fyerje dhe Shpifje dhe Kodit Penal.

Në fushën e Lirisë së Asociimit, Kuvendi ka miratuar plotësim-ndryshimin e Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, më 29.08.2011.

Në fushën e të drejtave të fëmijëve, pas hyrjes në fuqi të Kodit Penal për të Mitur, MD ka themeluar Këshillin Drejtues për reformimin dhe monitorimin e sistemit të Drejtësisë për të mitur. Ky këshill drejtues ka hartuar Rregulloren e brendshme si dhe Planin e Veprimit për vitin 2011. Gjithashtu në prill është vënë në funksion sistemi monitorues për Strategjinë dhe Planin Kombëtar për të Drejtat e Fëmijëve 2009-2013. Po ashtu me 25 gusht 2011, Qeveria ka themeluar Këshillin për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Drejtësi.

Sa i përket të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara, në gusht 2011 është përfunduar hulumtimin me titullin 'Sondazh i gjerë i popullsisë për Personat me Aftësi të Kufizuar'. Po ashtu janë realizuar këto aktivitete: Trajnim për të gjitha Njësive për të Drejtat e Njeriut në nivel qendror mbi metodologjinë e mbledhjes së të dhënave për Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar; Trajnim mbi ICF Klasifikimin Ndërkombëtarë të Funkcionalitetit për Komisionin Qendror të vlerësimit të pensioneve; Trajnimi dhe informimi mbi klasifikimin ndërkombëtarë mbi funksionalitetin (KNF) për përfaqësuesit e shërbimeve publike në komunën e Gjilanit.

Në fushën e barazisë gjinore, Qeveria ka miratuar Programin dhe Planin e Veprimit kuder Dhunes Familjare më 25 gusht 2011. Më tej, është realizuar hulumtimi kuantitativ "Gratë në Procesin e Punën dhe Vendimmarrjes", me 550 të anketuar. Gjithashtu, gjatë periudhës raportuese është funksionalizuar ueb-faqja e ABGJ-së, kurse me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të ABGJ-së 6 zyrtar kanë ndjekur trajnimet "Negocimi me BE" dhe "Menaxhimin e Buxhetit dhe Financave Publike. Me qëllim të përkrahjes së kategorive të grave të marginalizuara ABGJ ka subvencionuar këto aktivitete: Qendrën për rehabilitimin e Nënës dhe fëmijëve: Integrimi i Grave kryefamiljare në jetën shoqërore dhe vetëdijësimi i tyre për të drejtat e tyre të garantuara me ligj (gusht 2011);

”Trajnimi i grave te verbëta për përdorimin e alfabetit të Brejlit në mënyre elektronike (qershor 2011); Organizimi i trajnimit profesional për rehabilitimin e personelit të strehimoreve të Qendrës për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve.

Për sa i përket fuqizimit të mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivel komunal, MAPL, ka zhvilluar 4 module të trajnimeve në muajin qershor 2011, ku janë trajnuar 117 zyrtarë.

Gjatë vitit kalendarik 2011, me qëllim të përmirësimit të kushteve për të burgosur dhe arritjes së standardeve më të larta janë ndërmarrë këto veprime konkrete:

- Është filluar me ndërtimin e Burgut të Sigurisë së lartë;
- Është filluar me procedura për ndërtimin e dy Qendrave të reja të paraburgimit asaj në Prishtinë dhe në Gjilan,
- Është rinovuar në tërësi Objekti për të Mitur në Qendrën Korrektuese në Lipjan dhe funksionalizimin e kabinetit të informatikës,
- Është në renovim e sipër Qendra e Paraburgimit në Mitrovicë;
- Me instalimin e sistemit të kamerave në Qendrën Korrektuese në Dubravë, përfundon cikli i instalimit të kamerave për vëzhgim në Qendra Korrektuese.

Gjatë qershorit 2011 MD ka realizuar trajnimin e stafit i cili punon në sistemin shëndetësor të burgjeve në aspektin e kujdesit të veçantë në identifikimit dhe trajtimit të përdoruesve të drogave.

### **1.2.2. Të drejtat e minoriteteve, të drejtat kulturore dhe mbrojtja e minoriteteve**

Me qëllim të plotësimit të kornizës ligjore dhe asaj të politikave në fushën e trashëgimisë kulturore me vendim të Qeverisë më 29 qershor 2011 është miratuar dokumenti strategjik mbi konservimin e integruar të tërësive kulturore.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, në drejtim të zbatimit të legjislacionit mbi përdorimin e gjuhëve zyrtare janë miratuar rregulloret lokale për përdorimin e gjuhëve në këto komuna: Graçanicë, Pertesh, Ranillug, Shtërpce, Klllokot, Mamushë, Mitrovicë dhe Pejë. Në këto komuna gjithashtu janë themeluar njësitë e përkthimeve.

Komisioni për Përdorimin e gjuhëve ka pranuar dhe shqyrtuar 2 ankesa të parashtruara nga subjektet përkatëse, të cilat janë shqyrtuar.

Sa i përket përmirësimit të kornizës institucionale në fushën e mbrojtjes së minoriteteve janë themeluar Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim. Gjithashtu grupi Punues i udhëhequr nga MKK, për përshkrimin e Termave të Referencës dhe detyrave të punës për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim ka finalizuar këtë proces dhe këto dokumente janë miratuar nga ana Grupit Punues Qeveritar dhe u janë shpërndarë të gjitha komunave gjatë korrikut 2011.

Me qëllim të implementimit të kornizës së politikave për kthim vullnetar dhe ri-integrim, gjatë muajit qershor 2011, janë mbajtur tri aktivitete vetëdijësuese dhe të dialogut ndëretnik: në fshatin Rudnik – KK Skenderaj me PZHI-të nga komuniteti serb; në Gjakovë me PZHI-të nga komuniteti RAE; në Obiliq me PZHI-të nga komuniteti RAE, dhe gjithashtu janë mbajtur tri vizita `shko-shiko` si dhe dy vizita `shko-informo` për të zhvendosurit nga fshati Sllovinje – KK Lipjan në Serbi dhe për të zhvendosurit

nga fshati Zoqishtë – KK Rahovec në Serbi (për më shumë informacion për aktivitete që ndërliidhen me ri-integrimin e personave të riatdhesuar, shihni fushën e Drejtësisë, Lirisë dhe Sigurisë).

Me qëllim të përmirësimit të kushteve për kthim vullnetar dhe ri-integrim janë ndërmarrë këto veprime :

- Në Prizren janë ndërtuar 10 shtëpi dhe familjet e përfituesve janë vendosur në objekte të reja
- Është vazhduar projekti në Pogradje për kthimin e 13 familjeve të komunitetit serb ku është vazhduar me rikonstruimin e objekteve dhe riparimin.
- Projekti RRK II: janë përfshirë 4 komuna: Klina, Ferizaji, Obiliqi dhe Rahoveci. Deri në fund të Qershorit janë kompletuar 190 shtëpi. Në ndërtim e sipër janë 13 shtëpi në Klinë (7 shtëpi në fshatin Drenocë dhe 6 shtëpi në fshatin Budisavle). Gjer në muajin Qershor gjithsej janë dorëzuar në shfrytëzim 150 shtëpi, nga këto 22 shtëpi në Komunën e Klinës dhe 18 shtëpi në Komunën e Rahovecit.

Me qëllim të përmirësimit të kornizës ligjore në fushën e planifikimit hapësinor si dhe të respektimit të të drejtave pronësore është miratuar në Kuvend Ligji mbi Kadastrën më 29 korrik 2011.

Sa i përket ofrimit të shërbimeve mjekësore pjesëtarëve të minoriteteve Instituti i Shëndetit Publik ka bërë imunizimin dhe vaksinimin e fëmijëve, gjer më tani 831 fëmijë të komunitetit RAE.

### **1.3 Çështjet Rajonale dhe Obligimet Ndërkombëtare**

Në kuadër të *dialogut për çështje praktike të interesit të përbashkët me Serbinë*, pas konsolidimit të Qeverisë, më 24.02.2011 është caktuar lideri i delegacionit të Kosovës, si dhe ka draftuar dhe aprovuar Platformën e dialogut me 03.03.2011 duke formuar ekipin negociator. Për më tepër me 10.03.2011 Kuvendi i Kosovës ka miratuar një Rezolute që mbështet dialogun.

Që nga fillimi i dialogut, 8 mars 2011, në Bruksel, janë mbajtur pesë raunde të bisedimeve (raundi i parë – më 8 dhe 9 mars 2011; i dyti më 28 mars 2011; i treti më 15 prill 2011; i katërti më 17 dhe 18 maj 2011 dhe i pesti më 2 korrik 2011), dhe janë mbajtur një numër i takimeve në nivel ekspertësh. Gjatë kësaj periudhe, në këto takime janë adresuar dhjetë çështje:

- Lëvizja e lirë;
- Tregëtia e lirë (njohja e vulave të doganës së Republikës së Kosovoës)
- Regjistri civil;
- Dokumentat kadastral;
- Marveshjet e CEFTA-së;
- Energji;
- Telekomunikacion;
- Njohje e dyanshme e diplomave të shkollimit;
- Trashëgëmia kulturore dhe
- Personat e pagjetur.

Më 2 korrik 2011, janë arritur tri marrëveshje: për lëvizjen e lirë, njohje e dyanshme e diplomave universitare dhe të shkollave të mesme, dhe të regjistrimit civil. Sa i përket implementimit të këtyre marveshjeve, janë formuar grupet punuese dhe kanë filluar

takimet e para si dhe vizitat studimore. Implementimi i këtyre marrëveshjeve do të filloj atëhere kur mekanizmat për implementim të bëhet operacional, të udhëhequr nga BE-ja.

Raundi i gjashtë i bisedimeve, i caktuar të mbahet më 20 dhe 21 korrik 2011, ka dështuar për shkak se pala serbe nuk ka njohur vultat e Replikës së Kosovës. Dialogu pritet të vazhdoj më 2 shtator 2011.

Më tej, gjatë periudhës raportuese Kosova ka vazhduar të përballlet me barriera sa i përket *përfshirjes në punën e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (KBR/RCC)*. Në këtë kontekst, Kosova nuk ka marrë pjesë në Takimin e fundit të Bordit të KBR-së (mbajtur më 12 maj 2011, në Sarajevë) dhe në Takimin Vjetor të RCC-së (mbajtur më 28 qershor, në Budvë), ndërkohë që kanë vazhduar përpjekjet për gjetjen e një zgjidhjeje pragmatike ndaj këtij problemi, megjithëse obligimi financiar vjetor prej €40,000 është paraparë në kuadër të buxhetit, kjo shumë nuk i është paguar Sekretariatit të KBR-së.

Sa i përket kryesimit të *CEFTA*-së, Kosova ka vazhduar ta kryesojë atë edhe gjatë kësaj periudhe raportuese, gjatë së cilës janë mbajtur katër takime:

- Takimi i Nën-komitetit për Bujqësi dhe Masa Sanitare dhe Fitosanitare (1 maj 2011, në Bruksel);
- Takimi i Nën-komitetit për Dogana dhe Origjinë të Mallrave (në maj, në Tiranë);
- Takimi i Nën-komitetit për BTJT në Qershor (në Sarajevë)
- Takimi i eksperteve dhe i Zëvednësministrave (në qershor, në Prishtinë).

Më tej, gjatë janarit dhe shkurtit si dhe gjatë qershorit 2011 janë zhvilluar 60 pyetësorë me 10 kompani kosovare (prodhuese, shërbyese, tregtare, të shërbimeve, distributorë, transportuese etj.), mbi barrierat jo-tarifore. Nga përgjigjet e dhëna vërehet se ankesat më të mëdha të bizneseve ishin për bllokadën aktuale që Serbia dhe Bosnja e Hercegovina kanë vendosur ndaj Kosovës si dhe për ndalimin e masave preferenciale tregtare nga ana e BE-së.

Sa i përket bilancit tregtar me vendet e *CEFTA*-s, importet prej vendeve të *CEFTA*-s gjatë tremujorit të parë 2011, kanë shënuar vlerën prej mbi €171,000,000, kurse vlera e importeve vetëm nga Serbia dhe Maqedonia ka arritur vlerën në mbi €130,000,000. Sa u përket eksporteve të Kosovës në drejtim të vendeve të *CEFTA*-se, ato kanë shënuar vlerën prej €18,000,000, kurse eksportet drejt Maqedoniës dhe Shqipërsë kanë arritur vlerën prej €15,000,000.

Pjesëmarrja e nëpunësve civilë të Kosovës në aktivitetet e *Shkollës Rajonale për Administratë Publike (ReSPA)* ka vazhduar gjatë periudhës raportuese, gjatë së cilës është marë pjesë në 6 trajnime:

- Menagjment Strategjik (më 23 – 25 Maj 2011, në Danillovgrad);
- Metodët Trajnuese (më 24 – 26 Maj 2011 në Danillovgrad);
- Negociatat me EU (më 14 – 16 Korrik 2011 në Danillovgrad);
- Shkolla Verore në “E drejta Evropiane” (më 4 – 14 Korrik, në Luksemburg);
- Shkolla Verore - Kurs Intensiv në “Bashkimin Evropian” (më 4 – 22 Korrik 2011, në Bruzhë);
- Menagjim i Stafit (27 – 29 Korrik 2011).

Në fushën e *energjisë*, më 13 maj 2011 në Zagreb është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Kroacisë në këtë sektor. Është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit në mes të autoriteteve kosovare (MZHE-së dhe ZRRE-së) dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Sa i përket implementimit të Marrëveshjes mbi Hapësirën e Përbashkët Evropiane e Aviacionit (*Marrëveshjes ECAA*), gjatë periudhës raportuese AAC ka miratuar Rregulloren 4/2011 mbi Qasjen në Tregun e Shërbimeve në Tokë, përmes së cilës është transponuar Direktiva e BE-së nr. 96/67.

Në fushën e *bashkëpunimit ndërkuftar*, gjatë periudhës raportuese, janë finalizuar nga pala kosovare marrëveshjet financiare për Programin e BNK-së Kosovë - Shqipëri, dhe pritet përfundimi i procedurave të miratimit nga pala shqiptare. Më tej, më 26 korrik 2011 në Shkup është nënshkruar marrëveshja financiare për Programin Kosovë - Maqedoni, dhe i është përcjellë KE-së. Gjithashtu janë përgatitur vendimet për themelimin e Komiteteve të Përbashkëta Monitoruese për programet më të dy këto shtete.



## **2. KRITERET EKONOMIKE**

### **2.1 FUNKSIONIMI I EKONOMISË SË TREGUT**

Ministria e Financave, gjatë kësaj periudhe raportuese, ka vazhduar me ndërmarrjen e masave që janë në funksion të ruajtjes së qëndrueshmërisë buxhetore dhe stabilitetit makroekonomik.

Në qershor 2011, qeveria ka nënshkruar programin e ri Staff Monitoring Program me FMN-në. Po ashtu janë përmbushur dy veprimet paraprake të përcaktuara me këtë marrëveshje.<sup>2</sup> Po ashtu, Qeveria ka plotësuar kriteret e matshme duke mbajtur bilancin bankar në fund të qershorit në nivel më të lartë se që është përcaktuar me program. Gjithashtu, niveli i shpenzimeve ka qene më i ulët dhe suficiti primar ka rezultuar të jetë me i lartë se ai që është paraqitur si kriter i matshëm. Qeveria po ashtu ka arritur ta plotësoj zotimin e saj ndaj programit duke marrë vendimin për aplikimin e akcizës në lojëra të fatit dhe lejimin e importimit të veturave me të vjetra se 8 vite. Ky vendim ka filluar të zbatohet nga 1 korriku i vitit 2011.

#### **2.1.1. Raportimi në lidhje me zhvillimet e fundit ekonomike**

Në fund të muajit prill 2011, Qeveria ka aprovuar dokumentin e Vizionit të Kosovës për Zhvillim Ekonomik 2012-2015 duke nënvizuar prioritetet ekonomike për tri vitet e ardhshme. Bazuar në këtë dokument, një grup ekspertësh nga ministrië të lidhura më ekonomine kanë draftuar një plan të detajizuar me aktivitete që do t'i implementonin këto prioritete. Drafti final i këtij plani të veprimit është kryer me 1 korrik 2012 prderisa implementimi dhe monitorimi i arritjes së progresit fillon në gusht.

Për sa i përket gjysmë-vjetorit të parë të vitit 2011, eksporti i mallrave ka shënuar një rritje prej 18.6% duke arritur vlerën prej 168.1 milion eurosh përderisa importi i mallrave ka arritur vlerën 1,093.5 milion euro qe korrespondon me një rritje prej 16.5% krahasuar me të njëjtën periudhe të vitit 2010. Pritet që rritja e çmimeve ndërkombëtare të metaleve që parashihet për këtë vit do të ndikoj në një rritje më të theksuar të eksporteve të cilat për vitin 2011 janë parashikuar të rriten me 10.2% përderisa importet pritet të shënojnë një rritje prej 10.8%. Këto zhvillime tregojnë që nuk mund të pritet të këtë ndonjë përmirësim në bilancin e llogarisë rrjedhëse duke ditur që rritja e pagave në sektorin publik e po ashtu investimet e larta kapitale do të stimulojnë importin edhe më tej gjatë këtij viti.

Duke marrë për bazë trendet e deritanishme, ku ICK-së ka shënuar një rritje mesatare vjetore 9.6%, norma e inflacionit gjatë vitit 2011 pritet të arrijë në një mesatare prej 7%.

#### **Zhvillimet në Bilancin e Pagesave**

Parashikimet për llogarinë rrjedhëse sugjerojnë për thellim të deficitit të kësaj kategorie gjatë vitit 2011 e cila në një masë të madhe vjen si rrjedhojë e rritjes së konsumit dhe investimeve, veçanërisht atyre publike, e cila pritet të rritë edhe me shumë importin e mallrave dhe të thelloj edhe më tej bilancin tregtar. Parashikimet për vitin 2011 tregojnë që bilanci tregtar do të arrije vlerën 1,909 milionë euro e që korrespondon me një ngritje

---

<sup>2</sup> Shperndarja e komitetit për shqyrtimin e kriterëve për beneficione për të gjitha kategoritë e dala nga lufta, dhe stopimin e numrit të përfituesve i cili duhet të korrespondojë me nivelin/numrin deri në fund të Majit-2011, duke përjashtuar këtu numrin e aplikacioneve të pranuar deri më datën e lartcekur dhe aprovimin e aktin nën-ligjor për 'Ligjin për të drejtat e të përndjekurve politikë zyrtarë dhe personat e përndjekur' që përcakton se përfitimet e paguara me këtë ligj duhet të paguhen vetëm nga fondet që në mënyrë eksplicite dhe specifike janë krijuar për këto qëllime me ligjin mbi buxhetin.

vjetore prej 10% krahasuar me vitin 2010. Si rrjedhoje, bilanci i llogarisë rrjedhëse, pritet te rritet nga 16% e BPV sa ishte ne vitin 2010 ne 17.9% ne vitin 2011. Më saktësisht, të dhënat për tregtinë me jashtë për gjysmën e parë te vitit 2011 tregojnë se eksportet kanë vazhduar të rriten për 18.6% në krahasim me periudhën e njëjtë te vitit 2010 duke arritur vlerën prej 168 milionë euro. Në anën tjetër, importet janë rritur me një normë prej 16.5% duke arritur shumën prej 1,093 milionë euro. Ky relacion i zhvillimit në komponentët kryesorë të bilancit tregtar ka bërë që ky bilanc për këtë periudhë të thellohet për 16.1% për dallim nga periudha e njëjtë e vitit 2010.

Edhe pse niveli i lartë i importeve mbetet shtytësi kryesor i bilancit negativ të llogarisë rrjedhëse, rritja e BPV-së parashihet të ndikohet edhe nga sektori i jashtëm, duke pritur që paralel me ringjalljen e kërkesës globale dhe me ngritjen e çmimeve të mallrave, eksportet parashihet të kenë një rritje më të theksuar gjatë vitit 2011.

Investimet e huaja direkte të cilat përbënin rreth 7% të GDP-së gjatë vitit 2010 pritet të arrin vlerën prej 343 milionë euro duke shënuar një ngritje prej 10% krahasuar me vitin 2010. Ndërsa remitancat të cilat përbënin rreth 13% të GDP-së, sipas të dhënave preliminare, pritet te shënojnë një ngritje prej 2.4% në vitin 2011, me një diferencë në vlera nominale prej 10 milionë euro nga viti 2010. Megjithatë, me ringjalljen e ekonomisë së euro-zonës, trendi i remitancave mund të përmirësohet edhe më shume gjatë vitit 2011 e që mund të ketë ndikim pozitiv në përmirësimin e llogarisë rrjedhëse.

### **Trendet në punësim**

Bazuar në të dhënat e regjistruara mbi numrin e të papunëve nga Ministria e Punës dhe mirëqenies sociale, numri kumulativ i të regjistruarve si të papunë në fund të majit 2011 ishte 336,126. Trendi i të papunëve të regjistruar, i cili gjatë vitit 2010 qëndroj pothuajse stabil, në fillim të vitit 2011 trendi ka tendencë rritjeje. Ajo që vlen të potencohet është se që nga fillimi i vitit 2011, u shënuar një rritje mjaft e theksuar prej 866 personave në numrin e të papunëve të regjistruar (prej 335,260 sa ishin në fillim të vitit 2011 në 336,126 në fund të muajit maj 2011). Nga ana tjetër, numri i të punësuarve përmes zyrave të punësimit deri në fund të muajit maj 2011 arriti vlerën 3,020 persona. Vetëm gjatë muajit maj 2011 janë regjistruar 1,583 persona si të papunë ndërkaq që janë punësuar 681 persona.

### **Trendi i inflacionit, inflacioni bazë (përfshirë definicionin)**

Gjysmë pjesa e dytë e vitit 2010 si dhe gjysmë pjesa e parë e vitit 2011 u karakterizuan me një rritje në nivelin e përgjithshëm të çmimeve për dallim nga viti 2009 ku u shënuar ngritje negative në çmimet e përgjithshme. Bazuar në të dhënat e Entit Statistikor të Kosovës, në mesatare ngritja e çmimeve përgjatë gjysmë pjesës së parë të vitit 2011 shënoj 9.6%, përderisa mesatarja për periudhën e njëjtë në vitin 2010 ishte 1.4% dhe inflacioni për fund-vitin 2010 shënoj 3.5%.

Kontribuuesit kryesor në këtë ngritje vlerësohen të jenë ngritja e çmimeve të ushqimit dhe naftës të cilat gjatë kësaj periudhe shënuan një ngritje të theksuar në çmime. Në fund të muajit qershor 2011, çmimet e bukës dhe drithërave shënuan një ngritje vjetore prej 47.9% (të mira të cilat kanë ndikim prej 4.8% në IÇK), vajrat dhe yndyrërat shënuan ngritje prej 42.2%, ndërsa nafta dhe gazi shënuan një ngritje mesatare vjetore prej 14.7%. Përderisa rënie në çmime u vërejtën në produktet e perimeve. Siç shihet në figurën 1 në Aneks, niveli i inflacionit bazë (IÇK përjashtuar ushqimin dhe naftën) ka shënuar një

rritje mesatare prej 4.4% gjatë gjysmë pjesës së parë të vitit 2011 krahasuar me vitin 2010 kur ajo ishte 1.4%.

### **2.1.2. Raporti për politikat monetare dhe fiskale gjatë periudhës raportuese**

Nuk ka asnjë ndryshim nga periudha e kaluar raportuese në lidhje me evoluimin e kornizës së politikave monetare.

**Korniza e normës së këmbimeve:** Kosova përdorë euron prandaj norma nominale e këmbimit përcaktohet nga lëvizjet e euros kundrejt valutave tjera në tregjet ndërkombëtare. Sa i përket normës reale efektive të këmbimit, këto kalkuloohen duke marrë për bazë çmimet e konsumit të vendeve të cilat kane pjesëmarrje të madhe në tregtinë me Kosovën (Tabela 1).

### **Evoluimi i politikave fiskale**

Me buxhetin e vitit 2011 janë përcaktuar shpenzimet në nivelin prej €1,434 milion, ndërsa të hyrat e projektuara kapin shumën prej €1,261 milion. Nën supozimin e realizimit të plotë të të hyrave dhe shpenzimeve të projektuara, atëherë pritet që deficitin primar në vitin 2011 të jetë €173 milion, ndërsa deficitin i përgjithshëm (që përfshin pagesën e interesit dhe kredi-dhënien për ndërmarrjet publike) do rezultojë në €227 milion.

Në qershor të vitit 2011 është nënshkruar edhe marrëveshja SMP (Staff-Monitored Program) e cila ka për qëllim ankorimin e politikave të paraqitura në buxhetin 2011 dhe shmangien e iniciativave të reja fiskale që mund të çojnë deri te ngritja e shpenzimeve në vitin 2011. Për më shumë, Qeveria është zotuar të ndjekë kritere kuartale të përmbushjes së objektivave fiskale, kritere këto që do rishikohen po në të njëjtin afat kohor nga stafi i FMN-së. Në bazë të marrëveshjes SMP, kufiri i epërm i shpenzimeve primare qeveritare deri në Shtator 2011 është €902 milion, ndërsa deri në Dhjetor 2011 ky kufi do të jetë €1487 milion.

Për vitin 2011, është projektuar se €260 milion euro do të arkëtohen nga ATK. Deri në fund të Qershorit 2011, ATK ka arritur të arkëtojë €121milion, apo 47% të vlerës së projektuar vjetore. Krahasuar me €91 milion të mbledhura gjatë periudhës së njëjtë të vitit 2010, vërehet një ngritje prej 32% në nivelin e të hyrave të grumbulluara. Të hyrat në kufi janë projektuar të arkëtohen në nivelin prej €830 milion me buxhetin e vitit 2011. Autoritet doganore kanë arritur që deri në fund të qershorit 2011 të arkëtojnë €352, apo 42% të vlerës së projektuar vjetore. Krahasuar me vlerën e arkëtuar gjatë periudhës së njëjtë të vitit 2010, vërehet një ngritje prej 20.5% në vlerën e të hyrave të grumbulluara.

Gjatë periudhës janar - qershor 2011 po ashtu janë grumbulluar edhe €159 milion në formë të të hyrave jo-tatimore dhe në formë të të hyrave vetanake të grumbulluara nga Komunitet dhe nga organizatat e ndryshme buxhetore të nivelit qendror. Po ashtu, janë pranuar edhe €45 nga dividenda e deklaruar nga PTK-ja. Në total, në periudhën janar-qershor 2011 janë arkëtuar €579 milion, apo 46% e totalit të planifikuar. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2010, është shënuar një ngritje prej 8.6% duke marrë parasysh edhe faktin se dividenda e arkëtuar gjatë vitit 2010 ishte sa dyfishi i asaj të arkëtuar në gjashtëmujorin e parë të 2011-ës. Gjatë periudhës janar- qershor janë arkëtuar €528 milion, apo rreth 35% të vlerës së buxhetuar. Ky nivel shpenzimesh është për 13.3% më i lartë se sa niveli i shpenzimeve të regjistruara për periudhën e njëjtë të vitit 2010. Deri në

këtë periudhë, 73% e shpenzimeve janë realizuar nga Qeveria qendrore ndërsa 22% e shpenzimeve janë realizuar nga Qeveria lokale.

Në nivelin qendror, shpenzimet kapitale janë realizuar në normën prej 32% gjatë gjashtëmujorit të parë të 2011-ës, ndërsa në nivelin komunal këto shpenzime janë realizuar në nivelin prej 19%. Në total, gjatë periudhës së raportuar janë shpenzuar €169 milion euro në shpenzime kapitale, ndërsa janë shpenzuar €336 milion në shpenzime rrjedhëse (nga të dyja nivelet e qeverisjes). Po ashtu, gjatë kësaj periudhe, i janë disbursuar €21 milion KEK-ut në formë kredie.

Duke marrë për bazë nivelin e të hyrave dhe shpenzimeve, deri në fund të qershorit 2011, buxheti i Republikës së Kosovës është përcjellur më një suficit në vlerë prej €51 milion. Kjo edhe ka çuar nivelin e përgjithshëm të bilancit bankar nga €244 milion në fund të vitit 2010, në 295 milion në fund të Qershorit 2011.

Sa i përket ndryshimit të politikave fiskale, ka pasur ndryshime mjaft pozitive dhe të mirëpritura. Është arritur që përkundër rritjes së shpenzimeve në masë mjaft të madhe për paga të shërbyesve civil të ketë politika të cilat i ndihmojnë bizneset dhe konsumatorët. Limiti i vjetërsisë së automjeteve i cili ka qenë 8 vite, është zgjatur në 13 vite gjë që është një hap shumë pozitiv drejt liberalizimit total të tregut të automjeteve, dhe gjithashtu priten rritje të hyrave për gjysmën e dytë të këtij viti për shkak të përshkallëzimit të akcizës për automjetet më të vjetra, përkundër lirimit total nga akciza të automjeteve të reja. Gjithashtu, në qershor ka hyrë në fuqi akciza në lojërat e fatit dhe efekti i tyre pritet të matet në gjashtëmujorit të dytë.

#### **Borxhi i përgjithshëm i qeverisë:**

Shuma totale e paguar për servisim të borxhit për gjysmën e parë të vitit 2011 ka qenë rreth 10 milionë euro nga të cilat 5.7 milionë euro kanë qenë për pagesën e interesit dhe 4.1 miliona euro për pagesën e kryegjësë. Stoku i borxhit publik deri në Qershor të vitit 2011 ka arritur vlerën prej 254.7 milion euro nga të cilat 22 milion euro janë kredi nga FMN ndërsa pjesa janë obligime ndaj Bankës Botërore lidhur me borxhi e trashëguar nga periudha e ish Jugosllavisë.

#### **2.1.3. Funkcionimi i tregjeve të produkteve**

##### **Madhësia e sektorit privat**

##### **Agjencia Kosovare e Privatizimit**

Gjatë periudhës Maj-Shtator 2011 është miratuar futja në privatizim e valës 50, 51 dhe 52 e cila ka përfshirë gjithsej 81 ndërmarrje të reja. Prej tyre, në valën 50 dhe 51 tani më janë tenderuar 55 ndërmarrje të reja.

Gjatë periudhës raportuese janë miratuar transaksionet e valëve 49 si dhe të valës 50 në të cilat kanë qenë të përfshira gjithsej 24 ndërmarrje të reja. Finalizimi i kontratave të shitblerjes së aksioneve është në proces e sipër.

Është miratuar Shitja nëpërmjet Likuidimit 7 në të cilën kanë qenë të përfshira gjithsej 24 Ndërmarrje Shoqërore. Po ashtu gjatë kësaj periudhe është miratuar edhe shpërndarja përfundimtare e mjeteve dhe fondeve të likuidimit të KB VUSHTERRIA- Regjioni i Mitrovicës.

Gjatë periudhës raportuese, gjithsej 3273 punëtorë të 21 ndërmarrjeve kanë përfituar nga shpërndarja e parakohshme e 20% të të ardhurave të disponueshme nga shitja e ndërmarrjeve respektive.

### **Hyrja dhe dalja e bizneseve**

Ligji për Shoqëritë Tregtare është miratuar në Kuvend më 08.07.2011. Gjatë periudhës raportuese Agjencioni për Regjistrim të Biznesit ka hapur 14 Qendra për Regjistrim të Bizneseve nëpër Komuna. Në bazë të Ligjit 04/L-006 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.02/L-123 për Shoqëritë Tregtare nenit 12.1 dhe Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nenit 51 është marrë vendim që për te gjitha bizneset që aplikojnë për regjistrim fillestar të lirohen nga pagesa e taksës. Afati për regjistrim të Shoqërive me Përgjegjësi të Kufizuar është 3 ditë. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 2390 biznese dhe janë bërë ndryshime në 1478 biznese ekzistuese, si dhe se janë bere 278 shuarje. Numri i Pengjeve të Regjistruara në Zyrën e Pengut prej 01-05.2008 deri 01.09.11 është 11,191 dhe 623 kërkime.

### **Ambienti biznesor, sistemi gjyqësor dhe kapacitetet administrative:**

Gjatë periudhës raportuese MD ka kompletuar infrastrukturën legale të nevojshme për funksionimin e Ndërmjetësuesve në të gjitha fazat procedurale. Për këtë qëllim Komisioni i Ndërmjetësuesve ka përgaditur këto akte nënligjore: Rregullorja për licencimin e Ndërmjetësuesve (29.07.2011); Rregullorja për përgjegjësitë dhe procedurat disiplinore për Ndërmjetësuesve (14.06.2011); Rregullorja për trajnim dhe certifikim të Ndërmjetësuesve (05.05.2011), Rregullorja për regjistrim të Ndërmjetësuesve (05.05.2011).

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve, ndërmjetësuesit e trajnuar janë certifikuar nga Komisioni i Ndërmjetësuesve dha janë licencuar nga MD-ja. Deri më tani 90 kandidat janë trajnuar dhe 74 ndërmjetësues janë certifikuar më 29.07.2011.

Po ashtu është amandamentuar Ligji për Noterinë 2008/03-L-116, me ç'rast i ka përfshirë disa dispozita që janë konsideruar si pengesë në ambientin e përgjithshëm të biznesit.

#### **2.1.4. Sektori financiar**

Sektori financiar i Kosovës edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2011 kishte strukturë të ngjashme me vitet e kaluara, ku sistemi bankar përfaqëson sektorin më të madh, me 76.0 % të gjithsej asetëve të sektorit financiar. Sektori i dytë për nga madhësia përbëhet nga fondet pensionale, asetet e të cilave përfaqësuan 16.8% të gjithsej asetëve të sektorit financiar. Pjesa e mbetur e asetëve përbëhet nga asetet e institucioneve mikrofinanciare (3.9 %), kompanive të sigurimit (3.1%) dhe ndihmësve financiarë (0.2 %).

Sistemi bankar i Kosovës vazhdon të përbëhet nga 8 banka komerciale, prej të cilave 6 me pronësi të huaj dhe 2 me pronësi vendore. Pjesëmarrja e bankave të huaja në gjithsej asetet e sistemit bankar të Kosovës vazhdon të jetë e lartë, me 91.5 % të gjithsej asetëve të sistemit bankar të menaxhuara nga bankat e huaja. Struktura e tregut në sistemin bankar të Kosovës vazhdon të karakterizohet me një shkallë të lartë të koncentrimin, mirëpo që po shënon rënie të vazhdueshme. Në qershor 2011, pjesëmarrja e tri bankave më të mëdha në gjithsej asetet e sistemit bankar u zvogëlua në 74 % nga 77.4 % sa ishte në fund të vitit 2010.

Kreditë e lëshuara nga sistemi bankar i Kosovës po vazhdojnë të rriten, dhe atë me trend të përshpejtuar. Në qershor 2011, vlera e gjithsej kredive të lëshuara nga sistemi bankar arriti vlerën prej 1.62 miliard euro (34.3% e PBB-se)<sup>3</sup>. Norma vjetore e rritjes së kredisë në këtë periudhë ishte 15.7 %, krahasuar me 9.7 % në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, gjë që sugjeron për një rikuperim të normës së rritjes së kredidhënies në vend. Krahasuar me fundin e vitit 2010, norma e rritjes së kredisë ishte 11.4%. Struktura e kredive të sistemit bankar vazhdon të dominohet nga kreditë e lëshuara për ndërmarrjet, të cilat në qershor 2011 përfaqësuan 70.3 % të gjithsej kredive, përderisa ekonomitë familjare pranuan 29.7 % të gjithsej kredive. Për dallim nga dy vitet e kaluara, kur si pasojë e efekteve të krizës, bankat kishin shtrënguar kredidhënien për ndërmarrjet dhe zgjerimi i kredidhënies kryesisht ishte i orientuar drejtë ekonomive familjare, gjatë gjysmës së parë të vitit 2011 vërehet një zgjerim më i shpejtë i kredidhënies drejtë ndërmarrjeve. Gjatë kësaj periudhe, kreditë e lëshuara për ndërmarrjet shënuan një normë vjetore të rritjes prej 13.7 %, krahasuar me normën vjetore të rritjes prej 1.7 % të regjistruar në qershor 2010.

Mbështetja e lartë e ekonomisë së Kosovës në sektorin e tregtisë vazhdon të pasqyrohet edhe në strukturën e kredive të lëshuara për ndërmarrjet, ku dominojnë kreditë e lëshuara për sektorin e tregtisë që përfaqësojnë 52.5% të gjithsej kredive për ndërmarrjet. Një pjesë e rëndësishme e kredive i janë alokuar edhe sektorit të industrisë (përfshirë minierat dhe ndërtimtarinë) që ka pranuar 25.1 % të gjithsej kredive për ndërmarrjet, ndërsa sektori me më së paku kredi të pranuar vazhdon të jetë sektori i bujqësisë me vetëm 3.6 % të gjithsej kredive për ndërmarrjet. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit mbetet e ngjashme me vitet paraprake, ku 67.5 % janë kredi me afat maturimi prej mbi dy vite.

Norma mesatare e interesit në depozita në gjysmën e parë të vitit 2011 ishte 3.4 % (3.7 % në qershor 2010). Ndërsa, norma mesatare e interesit në kredi gjatë kësaj periudhe ishte 14.3 % (14.4 % në qershor 2010). Rrjedhimisht, diferenca ndërmjet normave të interesit në kredi dhe normave të interesit në depozita në gjysmën e parë të vitit 2011 ishte 10.9pp (10.7pp në qershor 2010).

Në gjysmën e parë të vitit 2011, sistemi bankar i Kosovës realizoi profit neto në vlerë prej 14.9 milionë euro, i cili është për 13 % më i ulët krahasuar me profitin e realizuar një vit më parë. Në zvogëlimin e profitit të sistemit bankar gjatë kësaj periudhe ka ndikuar rritja më e shpejtë vjetore e shpenzimeve (16%) në krahasim me rritjen e të hyrave (11.2%). Sistemi bankar i Kosovës vazhdoi të ketë nivel të lartë të kapitalizimit edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2011, me një tregues të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 17.2%. Gjatë kësaj periudhe, pjesëmarrja e kredive joperformuese në gjithsej portofolin kreditor shënoi rritje, duke arritur në 5.9%, krahasuar me 4.5% sa ishin në qershor të vitit 2010. Sidoqoftë, kreditë joperformuese vazhdojnë të jenë të mbuluara në nivel të kënaqshëm me provizione për humbje nga kreditë. Në qershor 2011, raporti ndërmjet provizioneve dhe kredive joperformuese ishte 115.7 %.

---

<sup>3</sup> Raporti ndërmjet kredive dhe PBB-së mund të rritet deri në fund të vitit, pasi që në mungesë të të dhënave kuartale për PBB-në, është përdorur projekcioni PBB-së për vitin 2011.

## **2.2. KAPACITETI PËR TU PËRBALLUR ME PRESIONIN E KONKURENCËS DHE FORCAVE TË TREGUT BRENDIA UNIONIT**

### **2.2.1. Kapitali Njerëzor dhe Fizik**

#### **Kapitali njerëzor:**

Që nga janari i vitit 2011 është filluar me realizimin e Veprimeve të Strategjisë së Punësimit sipas Plan Veprimit dhe rrjedha e tyre është sipas dinamikës së paraparë. Janë themeluar mekanizmat për monitorimin dhe implementimin e planit, përfshirë Grupin Drejtues për Strategjinë dhe Grupi për Zhvillimin dhe Monitorimin e Planit të Veprimit (10 maj 2011). Kështu në periudhën raportuese janë aprovuar 43 Projekte sipas Programit të Punëve Publike/Kosova 2011, përfitues janë 31 Komuna, ku gjatë periudhës raportuese në këtë program janë planifikuar të ndërmjetësohen në punësim 1823 punëkërkues.

Gjatë periudhës raportuese në 5 regjionet e Kosovës në bashkëpunim me AKB-në janë organizuar dhe mbajtur projekti "Berza e Punësimit- Kosova 2011" në të cilat janë ndërmjetësuar në punësim rreth 1000 punëkërkues. Divizioni për Aftësim Profesional përmes 8 Qendrave për Aftësim Profesional, nëpër 7 regjione dhe gjithashtu funksionojnë edhe 6 Qendra Mobile, ka bërë që 662 punëkërkues të aftësohen dhe riaftësohen për tregun e punës. Janë finalizuar punët e ndërtimit të QAP Ferizaj e cila ka 10 kabinete të trajnimit. Në bashkëpunim me UNDP është hapur qendra mobile në Serbobran afër Istogut në lëmin e rrobaqepësisë e cila do të shërbejë për ngritjen profesionale të komunitetit RAE që jetojnë në këtë zonë.

Në shkollat e mesme të larta në përgjithësi ka një rritje të vogël të numrit të nxënësve nga viti shkollor paraprak. Në vitin shkollor 2010-2011 numri total i nxënësve të regjistruar është 106 924, numri i nxënësve të regjistruar në klasën e dhjetë ka një rënie të lehtë nga viti shkollor paraprak. Gjersa në vitin shkollor 2009-2010 numri i nxënësve të regjistruar në klasën e dhjetë ka qenë 37521, në këtë vit shkollor 2010 -2011 numri i nxënësve të regjistruar në klasën e dhjetë është 32596 nxënës. Në sektorin publik kemi 60 mijë studentë të regjistruar ndërsa në sektorin privat kemi 16 mijë. Këtë vit në sektorin publik janë të hapura 18.200 vende për studentë të rinj, ndërsa në universitetet private ky numër do të dihet nga fundi i tetorit të këtij viti. Të dhëna të përafërta reflektojnë në një pjesëmarrje prej 20-22%. Informacione përkitazi me numrin e investimeve në kërkim dhe zhvillim nëpër kategoritë e ndryshme të granteve shkencore janë si në vijim: Grante Speciale Shkencore 57, Mobilitet Afatshkurtër i Shkencëtarëve 6, Shpërblimi "Hulumtuesi kosovar i vitit" dhe "Hulumtuesi i ri kosovar i vitit" 31, "Kthimi i Trurit" (Brain Gain), Financimi i Botimeve: 36.000 euros, Blerja e Eëb ISI knowledge, \$78.031.00. Është mbajtur "Java e Shkencës", janë publikuar të gjitha kumtesat e paraqitura në "Javën e Shkencës".

#### **Kapitali Fizik**

**Infrastruktura Rrugore:** Gjatë kësaj periudhe janë arritur rezultate në fushën e përmirësimit dhe zhvillimit infrastrukturor. Këtu para së gjithash duhet theksuar ndërtimin e autostradës Morinë-Merdar, ku janë zhvilluar punime të intensitetit të lartë në segmentet 1, 2 dhe 3 (Vërmicë-Prizren-Suharekë), me gjatësi prej 34 kilometrash, realizimi i përgjithshëm ka arritur 76.0%, Segmenti 4 Suharekë - Dule 22,90%. Krahas kësaj është punuar në plotësimin edhe të projekteve tjera ku është përfunduar projekti zbatues për segmentet 1-3, është përfunduar draft-projekti zbatues për segmentet 4-5, është përfunduar projekti preliminar për segmentin 7, dhe ka filluar punimi i projektit zbatues për segmentet 8-9. Përmirësimi, zhvillimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së

transportit dhe infrastrukturës e cila është e integruar në korridoret panevropiane dhe është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Aktivitetet më të rëndësishme që janë zhvilluar për arritjen e këtij objekti përfshijnë vazhdimin e projektit të zgjerimit të rrugëve nacionale M9 dhe M2. Segmenti M9 Sllatinë-Gjurgjicë përfshin asfaltimin e shiritave qarkullues dhe punimet në struktura. Punimet në këtë segment janë realizuar në nivelin 83%. Segmenti M2 Shkabaj-Milloshëvë është realizuar në nivelin 81%. Poashtu, në kuadër të programit të rehabilitimit të rrugëve janë përfunduar 30 km rrugë.

**Energjia:** KOSTT me qëllim të përmirësimit të cilësisë dhe ngritjes së kapaciteteve transmetuese dhe transformuese në Rrjetin e Transmisionit në periudhën raportuese ka përfunduar me implementimin e projektit për SCADA/EMS dhe Telekomunikacion (Supervisory Control and Data Acquisition/Energy Management System) & shërbimet konsulentë. Projekti ka përfunduar, zyrtarisht është lëshuar në punë më 01.07.2011. Po ashtu implementimi i Paket Projektit 400/110 kV Ferizaj 2 është në fazën finale dhe punët po zhvillohen sipas planit dinamik, ku 90% e punës është finalizuar. Gjithashtu në projektin 'Zëvendësimi i paisjeve të tensionit të lartë 400 kV në NS 400/220 kV Kosova B' janë përfunduar 80% e punëve dhe janë bërë testimet dhe komisionimet përkatëse të pajisjeve.

## **2.2.2. Reforma dhe liberalizimi i industrive të rrjetit**

### **Energjia**

Sa i përket rritjes së faturimit dhe pagesave, KEK-u raporton për një ngritje prej 3.76%, rritje prej 4.46% në pagesës si përqindje e faturimit dhe një rritje prej 8.04% e pagesës si përqindje e evergjisë e disponueshme për shitje. Sa i përket humbjeve komerciale, KEK-u raporton qe humbjet teknike janë 16.56% dhe humbjet komerciale janë 14.5%.

### **Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit:**

**Tregu i telefonisë mobile:** Tregu i telefonisë mobile ka vazhduar me një trend pozitiv të rritjes edhe në vitin 2011. Aktualisht 4 operatorë (2 MNO dhe 2 MVNO) janë aktiv në treg dhe shkalla e penetrimit deri më K1-2011 ka arritur mbi 85.51%<sup>4</sup>. Ndarja e tregut të 4 operatorëve mobil gjatë K1-2011 është si në vijim: Vala ka 71% të tregut, Ipko 24%, Z-mobile ka rreth 4%, dhe D3 Mobile ka vetëm 1% të tregut. Të ardhurat totale të katër operatorëve Mobil gjatë tremujorit të parë të vitit 2011 janë 39.6 mil euro. Sa i përket përdoruesve rreth 94.6% e tyre janë me parapagim, ndërsa vetëm 5.4% me kontrate.

**Tregu i telefonisë fikse:** Aktualisht penetrimi i shërbimeve të telefonisë fikse është rreth 5.12% në nivel të popullsisë.

**Tregu i internetit:** ART-ja i ka kushtuar vëmendje te posaçme këtij tregu duke ndërmarrë një sërë të aktiviteteve dhe masave rregullatore ne mënyrë që të mundësojë zhvillimin e rrjetave me shpejtësi të lartë të transmetimit të të dhënave, duke respektuar parimin e neutralitetit teknologjik me qëllim të rritjes së penetrimit të këtij shërbimi. Deri ne Gusht 2011 janë licencuar 21 operatorë për ofrimin e shërbimeve të internetit në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Penetrimi i shërbimeve brezëgjera (broadband) të internetit për momentin në Kosovë është rreth 47%.

---

<sup>4</sup> Penetrimi shërbimeve te telefonisë mobile është llogaritur ne baze te rezultateve preliminare te publikuara nga Enti statistikor i Republikës se Kosovës [eëë.esk-gov.net](http://eëë.esk-gov.net) , dallimi ne periudhën paraprake është se deri me tani ART ka marrë për baze vlerësimin se Kosova ka rreth 2070000 banorë.



**Autoriteti i Aviacionit Civil** ka lëshuar Rregulloren 7/2011 mbi tarifën që AAC i aplikon. Kjo rregullore hyn në fuqi më 15.08.2011 dhe i determinon tarifën shërbimit e ofruara nga AAC si: Certifikimi, Licencimi, Aprovimi dhe aktivitete të ndryshme mbikëqyrje të operatorëve ajror, aeroportin, ofruesit e navigacionit ajror dhe stafin e aviacionit civil.

**Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina:** Me qëllim të amandamentimit të legjislacionit sekondar janë aprovuar Rregulla për Komisionet Këshilluese të Konsumatoreve (Prill 2011) dhe Rregulla për Standardet Minimale të Shërbimeve (Maj 2011). Me 31 maj 2011 janë vendosur tarifën për kompanitë që grumbullojnë mbeturinat dhe për menagjimin e lokacioneve grumbulluese për periudhën qershor 2011 - maj 2012. Në gusht 2011 ka përfunduar raporti për vlerësimin e përmbushjeve të objektivave për kompanitë e ujit siç janë definuar në procesin e rregullatorit 2009-2011.

### **2.2.3. Zhvendosjet strukturore në ekonomi**

#### **Struktura sektoriale**

Në mungesë të të dhënave relevante për zhvendosjen sektoriale ndërmjet bujqësisë, industrisë dhe shërbimeve, këtë proces do ta paraqesim përmes indikatorëve agro-ekonomik të bizneseve të reja të krijuara dhe të regjistruara bujqësore. Sa i përket regjistrimit të ndërmarrjeve të reja nga sektori i bujqësisë, gjuetisë dhe pylltarisë, kemi një rritje prej 15.79 % në tremujorin e parë (T1) të vitit 2011 në krahasim me T1/ 2010<sup>5</sup>.

#### **Firmat e vogla**

Gjatë periudhës raportuese është miratuar Strategjia për Zhvillim të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme në Kosovë për vitin 2012-2016 (13.07.2011, Nr. 10/23). NVM-të përbëjnë mbi 99.95% të numrit total të ndërmarrjeve në Kosovë. Pjesëmarrja e NVM-ve në punësimin e përgjithshëm të sektorit privat është 80%, ndërkaq pjesëmarrja e tyre në BPV është rreth 43.3%. Ndërsa pjesëmarrja NVM-ve në qarkullimit përgjithshëm të sektorit privat është 76.21%.

Sipas madhësisë së NVM-ve: 98.4%, janë Mikro-ndërmarrje (1-9 punëtorë), Ndërmarrje të Vogla (10-49 punëtorë) janë 1.35%, Ndërmarrje të Mesme (50-249 punëtorë) janë 0.20% dhe Ndërmarrje të mëdha (mbi 250 të punësuar) janë 0.05%. Numri më i madh i të punësuarve është në kategorinë e mikro- ndërmarrjeve, ku sipas numrit të punëtorëve të regjistruar në ARBK në këtë kategori janë të punësuar 63.77%. Në ndërmarrje të vogla janë të punësuar 8.54%, në ndërmarrje të mesme janë të punësuar 7.85% .

Për nga forma e pronësisë zhvendosja e formave po ndodhë shumë ngadalë edhe pse ka një progres në format e tjera si të SHPK dhe Ortakërive. NVM-të që kanë formën e regjistrimit si biznes Individual përbëjnë mbi 89.50% të të gjitha formave të regjistrimit të bizneseve në Kosovë. Ortakëritë - 3.25%, Shoqëritë - 6.22%, Kompanitë e huaja - 0.48%, NSH - 0.01%, Ndërmarrjet publike - 0.02%, Kooperativat - 0.06%, ndërmarrjet nën AKM 0.03%.

#### **Struktura sektoriale e shpërndarjes së NVM-ve**

### **2.2.4. Intervenimet e Qeverisë në ekonomi**

#### **Ndërmarrjet e mëdha shtetërore**

<sup>5</sup> Raporti statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike në Kosovë për tremujorin e parë (T1) 2011, ESK

**Privatizimi i KKDFE:** Më 6 prill 2011, pas rekomandimeve të marra nga Komisioni Vlerësues për para-kualifikim dhe Këshilltari i Transaksionit IFC, Komiteti Qeveritar i Privatizimit të KEDS-it, ka marrë vendim unanim, që kompanitë: "Limak", "Çalik", "TAIB", dhe "Elseedy", t'i shpallë të Para-kualifikuara në procesin e Privatizimit të KEDS-it. Më 25 Maj 2011, është hapur Dhoma e të Dhënave për Investitorët e para-kualifikuar për t'u mundësuar zhvillimin e studimeve dhe vlerësimeve të tyre mbi kompaninë që pritet të jetë e hapur deri më 1 dhjetor 2011. Është themeluar Grupi Qeveritar për Projektet e Energjisë (GQPE) me përfaqësues nga secila Ministri, anëtare e Komitetit Qeveritar të Privatizimit si dhe nga institucionet kryesore në sektorin e energjisë si: ZRrE, KEK, KOSTT, KPMM, dhe PATEL. Deri më tani janë mbajtur 4 takime të GQPE, ku janë prezantuar, komentuar dhe përfunduar disa nga dokumentet kryesore të projektit të privatizimit të KKDFE, si: Memorandumi Informativ ("IM"), Draft Marrëveshja për Blerje me Shumicë të Energjisë Elektrike ("BSA"), Draft Kërkesa për Propozime ("RfP), Draft Marrëveshja për Shitblerje ("SPA"), etj. Më 19 dhe 20 korrik janë mbajtur takime në MZHE dhe KEK me kompanitë e para-kualifikuara për të diskutuar mbarëvajtjen e procesit dhe për të adresuar paqartësitë e palëve mbi procesin. Më 9 gusht është bërë aprovimi i draft Kërkesës për Propozime ("Request for Proposals") dhe draft Marrëveshjes për Shitblerje ("Share Purchase Agreement"), për të ju dorëzuar investitorëve të para-kualifikuar, në mënyrë që këto kompani/konzorciume të udhëzohen për përgatitjen dhe ftohen për dorëzimin e ofertave të tyre.

**PTK:** Qeveria me 27 korrik, sipas kërkesave ligjore, ka miratuar vendimin dhe strategjinë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Kuvendi më 27 korrik 2010 e ka miratuar në parim strategjinë. Në gusht 2010, Komisioni Qeveritar i Privatizimit të PTK ka shapllur thirrjen publike për para-kualifikim.

Komisioni Ndërministror, pasi analizoi hapat e ndjekur dhe analizat e bëra më parë, i ka rekomanduar Qeverisë të ofrojë në shitje 75 % të aksioneve të PTK-së dhe themelimin e Komisionit Qeveritar për Privatizim e PTK-së (KQP). Kuvendi i Kosovës me 31.03.2011 ka dhënë miratimin e tij (në dy lexime) për vendimin e Qeverisë nr. 02/03 për shitjen e 75 % të aksioneve të PTK-së. Më 3 qershor 2011 Para-kualifikimi është përmbyllur. Për privatizimin e PTK-së janë kualifikuar dy aplikantë: Hrvatski Telekom d.d. (HT), Kroaci dhe Telekom Austria AG, Austri.

**Hekurudhat e Kosovës:** Pas vendimeve të marra nga Qeveria e Kosovës, është përfunduar ndarja ligjore e Hekurudhave të Kosovës, duke u regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në MTI. Ndarja është bërë në Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës Sh.a (Infrakos) e cila do të bëjë menaxhimin, mirëmbajtjen, dhe ndërtimin e infrastrukturës hekurudhore, dhe në Operimet e Transportit të Hekurudhave të Kosovës Sh.a (Trainkos) e cila do të bënë menaxhimin dhe operimin e shërbimeve të transportit të udhëtarëve dhe mallrave.

**Ndihma shtetërore:** Ligji për ndihmën shtetërore Nr. 04/L-024 është aprovuar në Kuvendin e Kosovës më datë 29.07.2011. Si mekanizëm monitorues për ndihmën shtetërore është paraparë Zyra për mbikëqyrjen e ndihmës Shtetërore e vendosur në Komisionin e konkurrencës.

### 2.2.5. Integrimi tregtar

Të dhënat statistikore për periudhën Janar - Maj 2011 tregojnë se, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, është shënuar një rritje e vlerës së eksporteve dhe

importeve, por që Kosova ende është një vend i varur nga importet. Gjatë kësaj periudhe nga Kosova janë eksportuar mallra në vlerë mbi €134 mil, ndërsa janë importuar mallra në vlerë mbi €880 mil. Po ashtu gjatë kësaj periudhe eksporti i rregullt është në vlerë prej 40% e vlerës së eksporteve të përgjithshme ndërsa pjesa tjetër, apo 60% është ri-eksport, kryesisht eksport pas përpunimit të jashtëm. Kjo do të thotë se krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi një rënie të lehtë të eksporteve të rregullta dhe eksporteve pas përpunimit të brendshëm si dhe një rënie të vlerës të eksporteve për përpunim të jashtëm. Importet e rregullta përbëjnë 96% të importeve, ri-importi përfshinë vlerën prej vetëm 3.9%. Shih ne Aneks tabelën me të dhëna të përgjithshme për vlerën e eksporteve dhe importeve të Kosovës për periudhën Janar-Maj 2011.

Sipas destinacionit, apo sipas vendeve, gjatë 5 muajve të parë, pjesa më e madhe e tregtisë së Kosovës ka qenë e orientuar drejt vendeve të BE – së . Vlera e eksporteve për vendet e BE-së është mbi €67 mil ose 50% e totalit të eksporteve ndërsa vlera e importeve të mallrave është mbi €312mil ose 35.5% e totalit të përgjithshëm të importeve. Mirëpo vlen të theksohet se pjesa më e madhe e importeve në Kosovë, në këtë pesë mujor, është nga vendet e CEFTA-s dhe përfshinë 36.8% e totalit të përgjithshëm të importeve.

### **3. STANDARDET EVROPIANE**

#### **3.1. Tregu i Brendshëm**

##### **3.1.1. Lëvizja e Lirë e Mallrave**

Në fushën e tregut të brendshëm gjatë periudhës raportuese janë miratuar këto projektligje dhe UA:

- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-069 nr. 2004/18 Për Tregtinë e Brendshme nr. 04/L-005 është miratua në Kuvend me datë 23.06.2011;
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-069 për Akreditimin Nr. 04/L-007 është miratuar ne Kuvend me datë 16.06.2011 dhe është shpallur me dekretin nr. DL-002-2011 datë 28.06.2011.;
- Projektligji për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare nr. 04/L-006 është miratuar ne Kuvend me datë 23.06.2011 dhe është shpallur me dekretin nr. DL-008-2011 datë 08.07.2011.
- Udhëzim Administrativ "Për kërkesat teknike dhe metrologjike për termometrat elektrik medicinal për matje të vazhdueshme të temperaturës" me numër 09/2010 ( 14.06.2011);
- Nr. Udhëzim Administrativ "Për organizimin dhe funksionimin e komiteteve teknike" me numër 10/2010 (20.06.2011);
- Udhëzim Administrativ "Për pajisjet me gaz" me numër 11/2010 (01.07.2011)
- Udhëzim Administrativ "Për Produktet nga qelqi i kristaltë" me numër 12/2010 (25.07.2011);
- Udhëzim Administrativ "Për monitorimin e produkteve ndërtimore" me numër 13/2010 (25.07.2011);
- Udhëzim Administrativ "Kërkesat metrologjike për pajisjet me cilindra për matjen e forcës së frenimit" me numër 14/2010 (26.07.2011)
- Udhëzim Administrativ "Monitorimi i produkteve të Ndërtimit" me 25.07.2011

Sa i përket politikave të hartuara në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave, gjatë periudhës raportuese maj -shtator, AKS për këtë periudhë miraton 393 standarde evropiane EN dhe ndërkombëtare ISO/IEC si standarde kosovare SK, duke arritur kështu numrin e

përgjithshëm të standardeve në 3644 SK. Numri i përgjithshëm i KT-ve në AKS tash arrin në 18.

Sa i përket funksionalizimit të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë sipas kërkesave të ISO/IEC 17011 DAK(Drejtoria e Akreditimit e Kosovës) është vlerësuar për MLA (Marrëveshje Multilaterale) në EA (Korporatën Evropiane të Akreditimit) për laborator testues me nga data 15-20 Maj 2011. DAK vazhdon të marrë pjesë në të gjitha votimet dhe aktivitet tjera të ILAC (Forum Ndërkombëtar i Laboratorëve të Akredituar) si dhe IAF (Forum Ndërkombëtar të Akreditimit).

Janë mbajtur trajnime për anëtarët e Komisionit të "ri" të Këshillit të Akreditimit sipas kërkesave të standardit SK ISO/IEC 17025. Trajnimi për procedurën e vlerësimit të laboratorëve medicinal sipas kërkesave të standardit ISI/IEC 15189 dhe "Harmonizimi i kriterëve për vlerësues dhe përzgjedhja e vlerësuesve në rajon";si dhe "Mënyrat e ngritjes së vetëdijes për organizmat akreditues-Ekseriencë nga Bosna Deri më tani nga DAK janë akredituar 17 Organe për Vlerësim të Konformitetit prej të cilave 17 laborator testues dhe një trup inspektues.

### **3.1.2. Lëvizja e Lirë e Kapitalit**

Sa i përket plotësimit të kornizës ligjore sipas praktikave të mira ndërkombëtare dhe kornizës ligjore evropiane, është aprovuar nga Kuvendi Ligji për Sigurimet e detyrueshme Nr.04/L-018 të auto-përgjegjesisë i cili ka hyrë në fuqi me 30 korrik 2011.

Në lidhje me avancimin e mbikëqyrjes financiare në pajtim me standardet Bazel II për bankat dhe Solvenca II për sigurimet, janë përgatitur termet e referencës së grupit punues për përgatitjen e kornizës së rregullative dhe mbikëqyrëse sipas standardeve më të reja të komitetit të Bazelit për mbikëqyrje bankare, (veçanërisht kërkesat për kapital dhe principet bazë për mbikëqyrje efektive bankare).

Në lidhje me zhvillimin e sistemeve bashkëkohore ndër-bankare për ofrim të shërbimeve efektive për klientë, është finalizuar automatizimi i procesit të inicimit të transaksioneve dhe marrjes së informacionit nga ana e klientëve të BQK-së. Gjithashtu është funksionalizuar Njësia e Operacioneve të Tregut të Hapur. Në kuadër të BQK-së janë formuar ekipet (Bartës dhe ndihmës) me qëllim të implementimit me kohë dhe me sukses të këtij projekti.

### **3.1.3. Doganat dhe Tatimet**

#### **a. Doganat**

Deri më 22 gusht 2011 Dogana ka inkasuar €495 mil, apo 60% të projeksionit vjetor, ndërsa në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar 16% më shumë.

Në kuadër të zbatimit të ligjit për masa doganore dhe për mbrojtjen e të drejtës së Pronësisë Intelektuale, gjatë periudhës raportuese janë ndërmarrë masa konkrete si:

- Masa doganore për zbatimin e Ligjit të DPI-së si Aplikacione për DPI,
- Zbulimi i rasteve të shkeljes së Pronësisë Intelektuale dhe shkatërrim të mallit që shkel DPI-në:
  - 3 aplikacione të aprovuara për mbrojtje të 17 markave tregtare;

- o 16 raste të zbuluara nga Dogana e Kosovës, për të cilat dyshohet se shkelin pronësinë intelektuale, ku sasia e mallrave të U17 nga dogana është 23,293 njësi dhe vlerë prej 203.504 €;
- o 14 raste të shkatërrimit të mallit, ku gjithsej janë shkatërruar 29,945 njësi të mallrave që shkelin të drejtën e pronës intelektuale;
- o 5 raste në pritje për shkatërrim pas përcaktimit të mënyrës së shkatërrimit të mallit nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe agjencioni i AUK-ut dhe vendimit të gjykatës.

Gjatë kësaj periudhe në kuadër të Task Forcës, janë realizuar 271 raste prej të cilave 205 janë proceduar për kundërvajtje doganore, me vlerë prej €272,663.89 dhe gjobat e shqiptuara €399,846.50; 52 raste dënimi janë shqiptuar gjatë kësaj periudhe në vlerë prej €79,442. Në bashkëpunim me Policinë janë konfiskuar sasia prej 5581 gr e narkotikëve-heroinë.

Në kuadër të hulumtimit të rasteve për keqpërdorim të detyrës zyrtare/korrupsion janë iniciuar dhe përfunduar 2 raste, 5 zyrtarë të dyshuar dhe masat e shqiptuara janë: 1 vërejtje me shkrim dhe 4 ndalim promovimi;

Në kuadër të bashkëpunimit me doganat e shteteve tjera dhe në mes institucioneve të Kosovës, me 23.06.2011, është nënshkruar Marrëveshja e bashkëpunimit me Doganën e Sllovenisë.

- Më 04.07.2011, është nënshkruar protokoll i shkëmbimit elektronik të të dhënave në para-arritje me Doganën e Malit të Zi;
- Më 16.06.2011, është ratifikuar Instrumenti për aplikimin në Organizatën Botërore të Doganave nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- Më 27.07.2011, është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit mes Doganës dhe MTI, për çështje të së drejtës së pronësisë intelektuale.

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve profesionale në korrik ka përfunduar trajnimi bazik i 26 oficerëve kadetë, 5 nga të cilët do të zëvendësojnë 5 zyrtarë doganor që do të rekrutohen për Inteligjencë/DPI. Në fushat për hetime kriminale, teknikat dhe metoda të intervistimit dhe inteligjencës kriminale janë trajnuar 69 zyrtarë doganor. Po ashtu edhe trajnimi teknik është duke u zhvilluar për 6 zyrtarë për sistemin ASYCUDA eorld.

#### **b. Administrata Tatimore e Kosovës**

Administrata Tatimore e Kosovës nga prilli 2011 deri në korrik 2011 ka arritur progres në realizimin e projektit të fiskalizimit duke pajisur 3.383 biznese me 5.560 pajisje elektronike fiskale. Gjithsej deri tani janë pajisur 12.404 biznese me 16.480 pajisje elektronike fiskale. Gjatë kësaj periudhe raportuese janë lëshuar 4,110 numra fiskal.

Në kuadër të ngritjes së sistemit SIGTAS, gjatë kësaj kohe raportuese janë përfunduar edhe Moduli i Kontrollit, Mbledhjes dhe Ankesave. Gjithashtu është përfunduar ri hartimi dhe freskimi i manualit të kontrollit për tatimpagues. Krahas moduleve kryesore të SIGTAS të aktivizuara, janë futur në aplikim formularët e rinj tatimor (deklarata e tatimit në të ardhura nga ortakria) për ta shpejtuar procesin dhe për ta bërë më lehtë deklarimin.

Njësia për Hetime Tatimore, gjatë periudhës raportuese ka zhvilluar: ka përzgjedhur 42 raste për trajnim dhe për shqyrtim; 11 raste të përmbyllura; 2 raste të gatshme për Prokurorin; 2 raste të dorëzuara të Prokurorit dhe janë 27 raste në vazhdim të hetimeve.

Në kuadër të promovimit të politikave tatimore janë mbajtur 17 takime-tryeza me përfaqësues të tatimpaguesve (OEK, OEAK, AKB, SHKCAK) me qëllim të ngritjes së komunikimit për shqyrtimin e shqetësimeve të Tatim Paguesve, po ashtu janë mbajtur 17 seminare me tatimpagues.

Në ofrimin e shërbimeve elektronike gjatë kësaj periudhe raportuese janë shkarkuar 463,896 deklaratat sipas llojeve të ndryshme të tatimeve. Për këtë periudhë janë mbajtur trajnime në lëmin e zbatimit të legjislacionit tatimor dhe fushave të tjera të organizuara nga USAID-i, (6), EUCTA (8), OECD (6), CEF (1), IKAP (7), MDA (1) dhe KMI (1) si dhe trajnime për stafin sipas departamenteve, 15 trajnime. Po ashtu janë mbajtur 61 trajnime interne për fushën e zbatimit të legjislacionit të ri tatimor, numri i inspektoreve të trajnuar është 650.

#### **3.1.4. Konkurrenca**

Janë aprovuar nga Autoriteti i Konkurrencës tri akte nën-ligjore si:

- Rregullorja mbi punën e Komisionit të Konkurrencës (22.07.2011);
- Rregullorja mbi kriteret për shqiptimin e masës së sanksionit administrativ (22.07.2011);
- Rregullorja mbi kriteret dhe kushtet për caktimin e tregut relevant (22.07.2011).

Në vazhden e hetimit të sektorit të sigurimeve, është proceduar për hetim shitja e policave me auto-përgjegjësi nga pala e tretë. Hetimi mbi monitorimin e sigurimeve të detyrueshme për Palën e Tretë për Përgjegjësi ka përfunduar, bazuar në vendimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Është shfuqizuar vendimi i veçantë, Vendimi nr. 20/11 e datës 3.05.2011, për shfuqizimin e marrëveshjes së kontrolleve teknike. Ndërsa lidhur me kartelin për kontroll teknike, iu është bërë një rekomandim i veçantë Ministrisë së Infrastrukturës për shfuqizimin e UA nr. 2008/13 që ka të bëjë me mënyrën e bërjes së kontrolleve teknike. Në të njëjtën kohë po vazhdohet me hetimin e importuesve të mëdhenj të naftës dhe TPL-ne (Lloji i policës së sigurimit) e thjeshtë.

#### **3.1.5. Prokurimi Publik**

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) në bashkëpunim me Ekipin e Projektit të financuar nga Zyrën Ndërlidhëse të Komisionit Evropian (ZNKE) në Prishtinë është duke punuar në kompletimin e legjislacionit dytësor. Nga periudha 01 maj e deri më tani nga KRPP-ja ka shpallur edhe tri udhëzime Administrative:

- UA Nr. 04/2011 - për përdorimin e kriterëve të përzgjedhjes 19.05.2011;
- UA Nr. 05/2011 - për monitorimin e njoftimeve për publikimin e prokurimeve publike 19.05.2011;
- UA Nr. 06/2011 - për korrigjimin e keqkuptimeve të shpeshta në lidhje me Dosjet e Tenderëve 06.05.2011.

Nga testimi i zyrtarëve të prokurimit sipas kërkesave të ligjit ku trajnimet për prokurim publik janë të parapara të zgjasin 15 ditë në vit, janë mbajtur 521 trajnime për 521

zyrtarë të prokurimit, prej tyre 489 zyrtar të cilët kanë përfunduar me sukses testimin dhe janë certifikuar.

Nga periudha 01.05.2011 e deri më 01.09.2011 janë përfunduar monitorimet në 11 (njëmbëdhjetë) Autoritete Kontraktuese si monitorime të rregullta dhe 1 sipas rastit. Agjencia e Prokurimit Publik (APP)- e ka plotësuar numrin e punëtorëve për numrin i cili lejohet nga Ministria e Financave (2 punëtor).

Organi i Shqyrtimit të Prokurimit (OSHP) për periudhën raportuese, ka pranuar gjithsejtë 145 ankesa të operuesve ekonomik përfshirë edhe kërkesat e Autoriteteve Kontraktues për rishqyrtimin e vendimeve të APP-së. Prej tyre 135 ankesa janë të operuesve ekonomik të ushtruara kundër vendimeve të autoritetit kontraktues për dhënie të kontratës, kurse 10 janë kërkesa për rishqyrtimin e vendimeve të APP-së. Prej 135 ankesave të operuesve ekonomik, 110 janë shqyrtuara nga OSHP-ja, kurse 25 janë në shqyrtim e sipër. 39% të ankesave kanë shkuar në favor të operuesve ekonomik. Gjatë rishqyrtimit të vendimeve të APP-së, janë shqyrtuar 7 kërkesa, në shqyrtim e sipër dhe se janë edhe 4 kërkesa të Autoriteteve Kontraktuese. Në favor të Autoriteteve Kontraktuese kanë shkuar 40% të shqyrtimeve.

### **3.1.6. Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale dhe të Drejtat e Autorit**

Gjatë periudhës raportuese janë aprovuar tri ligjet bazë të pronësisë industriale si:

- Projektligji për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-54 për Markat Tregtare është miratuar në Kuvend me datë 29.07.2011 dhe është shpallur me dekretin nr. DL-017-2011 datë 09.08.2011;
- Projektligji për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-45 për Dizajn Industrial është miratuar në Kuvend me datë 29.07.2011 dhe është shpallur me dekretin nr. DL-013-2011 datë 09.08.2011;
- Projektligji për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/49 Për Patenta nr. 04/L-029 është miratuar në Kuvend me datë 29.07.2011 është shpallur me dekretin nr. DL-016-2011 datë 09.08.2011

Gjatë kësaj periudhe janë publikuar buletini i tretë dhe i katërt zyrtar.

Zyra për të Drejtat e Autorit ka punësuar dy zyrtarë të lartë dhe zyrtari i tretë është në procedurën e rekrutimit. Vlerësimi i nevojave për ngritje të kapaciteteve dhe plani i trajnimit të personelit të zyrës për të drejtat e autorit ka përfunduar. Ngritja e kapaciteteve për personelin e zyrës së të drejtave të autorit ka filluar në muajin korrik. Si aktivitete pasuese lidhur me mundësitë e trajnimeve të EUAPO të financuara nga ECLO përmes IPA-2009 dhe pas mbylljes së asistencës në maj 2011, Zyra për të Drejtat e Autorit ka zhvilluar Programin e saj të Trajnimeve për zyrtarët dhe hisedarët tjerë prej sektorit jo-qeveritar. Programi i Trajnimeve është aprovuar në korrik 2011 dhe përfshinë aktivitete trajnuese dhe shërbime që ofrohen nga zyra: Hyrje në punë, Procedurat Administrative, Bashkëpunim Ndër-institucional dhe zhvillim të karrierës si dhe menaxhim kolektiv i të drejtave të autorit. Trajnimi i parë është realizuar më 11 korrik 2011 me përfaqësuesit e radio-stacioneve kosovare, dhe 2 trajnime në punë me stafin e zyrës më 16 korrik 2012 dhe më 22 gusht 2011.

### 3.1.7. Punësimi dhe Politikat Sociale

Gjatë periudhës raportuese janë hartuar dhe aprovuar këto UA:

- UA Nr. 06/2011 për Punë dhe Vendosjen e Personave me atësi të kufizuara mendore (zhvillim të vonuar mendor) në Institutin Special në Shtime dhe nëpër shtëpitë e Komunitetit 01.04.2011;
- UA Nr. 07/2011 për Aktivitetet dhe kriteret e vendosjes së banorëve në shtëpitë për personat pa përkujdesje familjare dhe shtëpite e komunitetit 01.04.2011
- UA Nr. 01/2011 për determinim e procedurave pas transferimit të përgjegjësive shërbimeve familjare dhe sociale tek niveli komunal 05.04.2011.

Njësia e Kontrollit dhe Mbikëqyrjes e DMS/MPMS-së gjatë kësaj periudhe raportues (maj-gusht 2011) ka kontrolluar 8 QPS, me ç'rast ka kontrolluar 532 dosje/lëndë të shfrytëzuesve të ndihmës sociale. Prej tyre, 460 lëndë kanë qenë të kompletuara me dokumentet përkatëse, ndërsa 72 lëndë kanë pas mungesë të ndonjërit nga dokumentet e kërkuara. Veç kësaj, kjo Njësi konstaton se 184 familje kanë qenë të përzgjedhuara në harmoni me kriteret dhe kushtet që parasheh Ligji i SNS-së, ndërsa 16 familje kanë qenë, të papërzgjedhshme dhe në kundërshtim me Ligjin e SNS-së, të cilat automatikisht janë larguar nga ndihmat sociale.

Janë inspektuar 2525 subjekte. Inspektime të rregullta janë bërë në 1320 në subjekte ekonomike, në 421 subjekte ekonomike është bërë inspektim i përsëritur, kurse me kërkesën e palëve janë inspektuar 97 subjekte ekonomike. Janë kryer 367 inspektime në bashkëpunim me organet tjera zyrtare në subjektet ekonomike. Për mos respektim të dispozitave ligjore ndaj subjekteve ekonomike janë shqiptuar 387 masa ndëshkuese prej tyre 329 vërejtje me shkrim dhe 58 gjopa në të holla.

Inspektorati i Punës në bashkëpunim me ATK-në, Policinë e Kosovës, Inspektoratin e Shëndetësisë si dhe me institucionet tjera relevante që bëjnë mbikëqyrjen e dispozitave ligjore ka kryer 367 inspektime ndaj subjekteve ekonomike për luftimin e ekonomisë jo formale. Janë inspektuar 367 subjekte ekonomike dhe janë legalizuar 1045 punëtor të cilët punonin pa kontrata pune dhe tani janë pajisur me kontrata punë.

Është bërë instalimi i Sistemit të SIMP-it në të gjitha Qendrat Rajonale të Punësimit dhe në nivel qendror ku edhe është bërë centralizimi i këtij sistemi. Po ashtu, janë demonstruar modulet e rishikuara sipas kërkesave të Departamentit të Punës dhe Punësimit.

MPMS gjegjësisht Departamenti i Punës dhe Punësimit përmes Bankës Botërore aktualisht është në zbatim e sipër të Programit "Punët Publike, Kosova 2011". Ky program do të zbatohet në 29 komuna të Kosovës.

Plani i Veprimit për Strategjinë Sektoriale 2011/2013 është aprovuar dhe janë krijuar mekanizma për monitorimin e implementimit të këtij plani, duke u themeluar Grupi Drejtues i Strategjisë (GDS), dhe Grupi për Zhvillimin dhe Monitorimin e Planit të Veprimit për Strategjinë (GZHMPS).

Për periudhën maj - korrik 2011 në 8 QAP dhe 6 njësit e tyre mobile kanë përfunduar trajnimin dhe janë certifikuar 622 kandidatë. Përmes projektit KOSVET 6 kanë përfunduar trajnimin në punë dhe janë certifikuar gjithsejtë 530 kandidat.



Ngritja e kapaciteteve institucionale në fushën e shërbimeve shëndetësore realizohet përmes këtyre aktiviteteve:

- Moduli i sistemit të informimit për shëndetin është funksionalizuar plotësisht në QKUK dhe QKMF në Mitrovicë;
- Sistemi Elektronik për Menagjimin Farmaceutik është funksional në MSh. Moduli online i këtij sistemi është i implementuar në të gjitha institucionet e shëndetit publik në mbarë Republikën e Kosovës dhe është plotësisht i funksionalizuar;
- Këshilli Kosovar për Protokole Klinike është themeluar me 16.02.2011 dhe është plotësisht funksional.

### **3.1.8. Arsimi dhe Hulumtimi**

Gjatë periudhës raportuese maj-shtator 2011 nga Qeveria e Kosovës janë miratuar:

- Ligji për Arsimin Parauniversitar me datë 29.08.2011 dhe
- Ligji për Arsimin e Lartë me datë 29.08.2011.
- Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011-2016 është miratuar nga Qeveria e Kosovës në gusht 2011.

Me qëllim të zbatimit të legjislacionin për trajnime profesionale janë zhvilluar dhjetë (10) standarde profesionale. Në kuadër të zhvillimit të kornizës kombëtare për monitorim dhe vlerësim të mësimin, është hartuar dhe miratuar:

- UA për validimin e kualifikimeve profesionale dhe akreditimin e ofruesve të Arsimit dhe Aftësimin Profesional AAP shkurt 2011.

Me mbështetjen e projektit EU KOSVET V është zhvilluar dhe pilotuar metodologjia përmes procesit të validimit të kualifikimeve tek 10 ofrues të AAP në Kosovë.

Krijimi i kushteve adekuate për fëmijët me nevoja të veçanta vazhdon, ku 183 mësimdhënës kanë kaluar nëpër programe të ndryshme trajnime nga janar- gusht 2011.

Është siguruar pjesëmarrje më e madhe e Kosovës në programet e BE-së për arsimin e lartë. Si rezultat i aplikimeve me projekte në FP7 më 2010, është aprovuar një projekt nga Kosova më 2011 (projekti "Supporting dialogue and cooperation between Europe and Kosovo in collaborative ICT R&D, i nënshkruar më datë 11.07.2011 me kohëzgjatje prej dy (2) vjetësh). Për ERASMUS MUNDUS nga Kosova kanë aplikuar gjithsej 228 student dhe staf akademik nga Institucionet Publike dhe Private të Arsimit të Lartë.

Për të shtyrë përpara zhvillimin e politikave për inkurajimin e kërkimeve, janë ndarë 15 grante për projekte shkencore, është ndarë granti për mobilitet afatshkurtër në vendet e BE-së në të cilën kanë marrë pjesë 5 persona. Janë mbështetur 13 botime.. Është botuar revista shkencore me punimet shkencore të prezantuara në Javën e Shkencës për botimin e Konferencës së Institutit të Albshkencës që të bëhet parapagimi i abstrakteve të projekteve të përfunduara kërkimore.

Në kuadër të programit IPA-2010 është aprovuar një projekt "Communities and education" në vlerë prej 1 Milion euro në fushën e shkencës. Është caktuar pika e kontaktit kombëtar për programin Framework program 7 (FP7).

Në katër qendra didaktike janë instaluar pajisje të Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit (TIK) dhe janë realizuar trajnime të burimeve njerëzore në aplikimin e TIK-ut.

Dyzet institucione të arsimit parauniversitar duke përfshirë edhe tri shkolla për fëmijët me nevoja të veçanta janë pajisur me kabinete të TIK-ut dhe më se 2500 mësime të mësimdhënësve dhe burime tjera njerëzore të angazhuara në procesin arsimor janë trajnuar për aplikimin e TIK-ut në sistemin arsimor. Trajnimi i ECDL është duke u realizuar dhe synohet të përfshijë të gjithë mësime të mësimdhënësve të institucioneve publike. Janë vënë themelet e krijimit të qendrës së mësimi elektronik dhe të rrjetit nacional akademik KOSNet. Janë krijuar përmbajtje elektronike në katër gjuhë të komuniteteve të Kosovës. Është themeluar baza për integrimin e Mësimi elektronik në sistemin arsimor të Kosovës.

UA për implementimin e standardeve të librave shkolle dhe korniza e korrikullit të Kosovës është aprovuar nga Ministri në gusht 2011.

## **3.2. Politikat Sektoriale**

### **3.2.1. Industria dhe NVM-të**

Agjencia për mbështetjen e NVM-ve, në bashkëpunim me akterë e tjerë qeveritar dhe me asociacione biznesi, ka hartuar "Strategjinë për zhvillimin e NVM-ve 2011-2016 me vizion 2020" e cila është aprovuar nga Qeveria e Kosovës më 13 Korrik 2011. Më datë 21.07.2011 është nënshkruar akti i themelimit të Asociacionit për Zhvillimin e NVM-ve kosovare me Asociacionin e NVM-ve për Evropën Jug-lindore.

Sa i përket skemës Vaucher për Këshillime dhe Trajnime, gjatë periudhës raportuese, Agjencia e NVM-ve ka pranuar 7 aplikues që në numrin total tanimë kemi 32 aplikues, të cilët do të ofrojnë këshilla dhe trajnime.

Lidhur me **Aktin Evropian i Bizneseve të Vogla** me 28 dhe 29 qershor 2011, në Prishtinë, Institucionet e Kosovës së bashku me delegacionin e Komisionit Evropian kanë realizuar një takim dy ditorë për "Vlerësimin" e Dimensionit 1 dhe 8 të Aktit të Bizneseve të Vogla (ABV), me qëllim të vlerësimit të progresit të Kosovës në këto dy dimensione.

Në këtë periudhë raportuese AMV ka hartuar dokumente të rëndësishme për funksionalizimin e Zonave Ekonomike, ku më 4 Korrik 2011 ka publikuar dokumentin Strategjik për programin e Menaxhimit të Zonave Ekonomike. Në mënyrë aktive me inkurajimin e komunave tjera të Kosovës që kanë planifikuar themelimin e Zonave Ekonomike (bazuar në Ligji për Zona Ekonomike № 03/L-129). Për ta ndihmuar këtë proces është hapur konkursi për mbështetjen e Komunave, që kanë nevoja për studim fizibilitetit me qëllim të themelimit të Zonave Ekonomike dhe se si rezultate të këtyre veprimeve, tanimë kemi 15 Aplikacione (Komuna Aplikuese). Gjithashtu, lidhur me këtë është krijuar bazën e të dhënave të aplikanteve, po ashtu dhe hartimin e kriterëve vlerësues.

Sa i përket Parkut të Biznesit në Drenas tanimë është shpallur konkursi i tretë (17.06.2011) për të cilën tanimë kanë aplikuar 23 biznese, pjesa më e madhe e të cilave do të vlerësohet deri në fund të këtij viti.

Në drejtim të vlerësimit dhe ngritjes së vetëdijes për NVM-të, ka përfunduar Projekti "Hulumtimi i 800 Ndërmarrjeve, mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM)", me ç'rast është publikuar (07.02.2011) raporti lidhur me këtë. Nga ky raport janë analizuar 783 NVM dhe se janë nxjerr rekomandime.

Sa i përket Themelimit të qendrave komunale për regjistrimin e bizneseve "one stop shop" në 14 komuna, me 14.06.2011 është përfunduar faza e dytë e projektit ku në përputhje me planin dinamik kohor janë hapur 14 qendrat Komunale për regjistrim të bizneseve. Në funksion të shkëmbimit të përvojave në fushën e Promovimit të Investimeve dhe Eksportit, Agjencia për Promovimin e Investimeve në Kosovë (APIK) ka realizuar vizita në Kroaci dhe Mal të Zi. Katër Zyrtar nga APIK-ut kanë marrë pjesë në Vienë të Austrisë në trajnimin e organizuar nga Zyra e APIK-ut për përdorimin CRM ACT 2011 (softuerit).

Me dt. 21.06.2011 është formuar grupi punues ndërministror për reformën e ambientit biznesor, ndërsa me dt. 22.07.2011 janë formuar nën-grupet punese për "fillimin e bizneseve" të cilat do të nxjerrin rekomandime për Qeverinë për krijimin të një klimë më të mire Inventive.

### **3.2.2. Bujqësia dhe Peshkataria**

Gjatë kësaj periudhe në fushën e Legjislacionit, MBPZHR i ka kryer këto veprime si vijon:

- Ndryshim-plotësimi i Ligjit për Verëra është miratuar nga Kuvendi i Kosovës me 28.07.2011;
- Është miratuar strategjia për Konsolidimin e Tokave Bujqësore nga Qeveria e Kosovës, me datën 29.06.2011, Vendimi Nr. 09/21.
- Me datën 15.07.2011 janë dhënë tri pëlqime nga MBPZHR në komunën e Gjilanit për themelimin e vend gjuetive të përbashkëta:.

Për rehabilitimin e sistemit të ujitjes janë ndërtuar 2 (dy) penda të ujitjes: Penda e ujitjes me kanal në Broliç-Pejë, 450m, për ujitjen e 200/ha, dhe Penda e ujitjes me kanal në Brovinë-Gjakovë, 750m, për ujitjen e 500/ha.

Në lidhje me krijimin e sistemit të informimit për tokat e ndotura në Kosovë deri me tani janë marrë 1,000 mostra reprezentative në 400.000 ha tokë të punueshme bujqësore, ku janë kryer bio-testet për të gjitha mostrat. Janë përzgjedhur 123 mostra për analiza kimike të plotë në laborator të kontraktuar në Gjermani. Është përgatitur harta në bazë të sistemit koordinativ Kosref 01.

Ngritja e sistemit të informacionit të thjeshtëzuar të parcelave të tokës është duke u krijuar me sukses në komunat pilot: Suhareka, Peja, Istogu, Kaçaniku, Graçanica, Vitia dhe Prishtina. Zyrtarët komunal janë trajnuar, janë siguruar orto-fotot dhe hartat topografike që shërbejnë për krijimin e LPIS-it, për këto komuna. Deri më tani janë vendosur 1402 ha në LPIS.

Është bërë rekrutimi i 10 punëtoreve për përgatitjen e sipërfaqeve për përkujdesjen e fidanëve të mbjellura. Në fidanishte aktualisht janë duke u kultivuar 1.800,000 fidanë klasike dhe industrial. Është bërë publikimi i tenderit për pyllëzimet vjeshtore të 302/ha pyje.

Për parandalimin e shkatërrimit të pyjeve dhe tokave pyjore nga shfrytëzimi i gurëve dhe zhavorrit deri tani, janë kryer 65 kontrole në inspektimin e pyjeve publike, private, monitorimin dhe mënyrën e shfrytëzimit të tyre. Janë kontrolluar 61 subjekte të përpunimit primar të drurit. Në tregje dhe depo të ndryshme grumbulluese janë kryer 110 kontrole si dhe janë vizituar të gjitha Autoritetet Pyjore Komunale në mënyrë që t'u ofrohet ndihmë në parandalimin e shkatërrimit të pyjeve. Janë konfiskuar 390 m<sup>3</sup> masë drunore në qarkullim ilegal. Janë lëshuar 50 vendime dhe urdhëresa të ndryshme për ndalesa, urdhëresa dhe zbatueshmëri të ligjit. Janë ngritur 78 fletëparaqitje për veprime të kundërligjshme në pyje dhe toka pyjore. Janë lëshuar 17 kontrata për gurthyes në tokat pyjore shtetërore. Është lëshuar 1 pëlqim për gurëthyes në pronën private. Ndërsa janë ndërpre 8 kontrata për shfrytëzimin e tokave pyjore për shkak të mospërbushjes së kushteve të parapara me kontratë. Janë ngritur 3,732 fletëparaqitje nga prerjet e paligjshme të cilat përmbajnë masë drusore 9581.41 m<sup>3</sup>, me vlerë të dëmit prej €1,309,282.88. Prej këtyre fletëparaqitje 2590 janë për kundërvajtje që përmbajnë masë drusore 4,105.52 m<sup>3</sup> dhe 1,142 fletëparaqitje penale që përmbajnë masë drusore 5,475.89 m<sup>3</sup>. Për hartimin e planeve menagjuese janë kontraktuar dy Operatorë Ekonomik të cilët kanë realizuar fazën e pare për 31.849.61 /ha. Qeveria Norvegjeze përmes NFG është në fazën përfundimtare të hartimit të planeve menaxhuese për 12,000 ha.

### **Siguria e Ushqimit dhe Veterinaria**

Gjatë periudhës raportuese janë nënshkruar Memorandumet e Mirëkuptimit me Kuvendet Komunale të Pejës (23.06.2011), të Mitrovicës (30.06.2011), të Prizrenit (28.07.2011), përmes të cilave është siguruar ambientet për vendosjen e inspektorëve regional dhe komunal.

Me vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm Nr. 264 të dt. 03.08.2011 është formuar Grupi Qeveritar i Punës për shqyrtimin e projekt-rregulloreve nga Paketa Higjienike.

Në këtë periudhë është bërë identifikimi dhe matrikulimi i 12,547 gjedheve të ri; praktikat veterinare janë ngarkuar me 14500 numra të matrikulimit, është bërë futja e të dhënave direkt në data bazën e sektorit I&R. Matrikulimi i ruminanteve të vegjël dhe derrave është në fazën përfundimtare ku deri më tani janë procesuar 163,456 të dhëna të sjellura nga tereni. Gjatë kësaj periudhe është bërë rifreskimi i bazës së të dhënave ku fermerët të cilët kanë aplikuar për subvencionim kanë sjellë të dhënat e sakta të fermave të tyre, po ashtu praktikat veterinare i kanë raportuar direkt në bazën e të dhënave. Është duke u bërë monitorimi i praktikave veterinare të cilat kanë kryer matrikulimin e deleve, dhive dhe derrave. Ëeb faqja e sektorit I&R tani më është funksionale.

### **3.2.3. Mjedisi**

Sektori i mjedisit ka vazhduar të plotësoj bazën ligjore përmes së cilës funksionon, duke aprovuar në Kuvend ligjet si:

- Projektligji për Kadastrën (aprovuar në Kuvend më 29.07.2011);
- Projektligji për Themelimin e Regjistrisë të Drejtave të Pronës së Paluajtshme;

Si rrjedhojë e procesit të plotësimit të kornizës ligjore, përmes legjislacionit sekondar, MMPH ka miratuar këto udhëzime administrative si vijon:

- Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2011 për metodologjinë e vlerësimit të rrezikut nga aksidentet kimike si dhe masat për eliminimin e pasojave (12.04.2011)

- Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2011 për provimin profesional dhe licencimin e arkitekteve dhe inxhinierëve në fushën e ndërtimit (18.05.2011)
- Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2011 për licencimin e hartuesve të raporteve për vlerësimin e ndikimit në mjedis (13.07.2011)
- Udhëzimi Administrativ Nr. 08.2011 për grumbullimin e llojeve të bimëve të egra, të mbrojtura me qëllim të përpunimit dhe tregimit (13.07.2011)
- Udhëzim Administrativ Nr.09/2011, për informim, pjesëmarrje te publikut dhe palëve te interesuara ne procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis, i nënshkruar me datën 13.07.2011.
- Udhëzimi Administrativ Nr.10/2011, për pengimin e aksidenteve të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme, i nënshkruar me datën 13.07.2011.
- Udhëzimi Administrativ Nr.11/2011, për përcaktimin e vlerës se tarifës për shërbimet lidhur me procesin e vlerësimit te ndikimit ne mjedis, i nënshkruar me datën 13.07.2011.
- Udhëzimi Administrativ për Normat e Cilësisë së Ajrit i nënshkruar nga Kryeministri i Republikës së Kosovës me datën 20.07.2011.

Në kuadër të synimit për përmirësimin e politikave strategjike në fushën e mjedisit, me datën 16.06.2011 është miratuar Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020. Për më tepër, është miratuar edhe Plani Hapsinor me interes të veçantë Ekonomik 'Fusha e Mihjes së Re 2010-2020.

MMPH me datë 20.06.2011 nxori vendimit Nr. 015/2011 për themelimin e Autoritetit Rregullativ për Mbrojtje nga Rrezatimi. Me këtë rast ARMRK, ka të emëruar U.D. të Kryeshefit dhe dy zyrtarë. Me datën 10.06.2011 MMPH po ashtu ka nxjerrë vendimin Nr. 011/2011 për mbrojtjen e përkohshme të zonës potenciale për shpallje Zonë e rëndësishme e Zogjve (IBA) për Ligatinën e Hencit (Komuna Fushë Kosovë dhe Lypjan) në sipërfaqe prej 50 ha, kurse zona në tërësi ka rreth 1.821 ha.

Deri më tani janë ndërtuar 5 impiante për sterilizimin e mbeturinave infektive: në Prishtinë, Mitrovicë, Prizren, Gjilan dhe Ferizaj i cili është fazën testuese. Katër nga objektet e lartpërmendura janë pajisur me pajisje për sterilizimin e mbeturinave infektive spitalore. Në vazhden e tentimit për të përmirësuar politikat e banimit, është themeluar këshilli për banim me 5 anëtarë të përzgjedhur. Për më tepër, në vijën e angazhimeve për krijimin e rrjetit të monitorimit të cilësisë së ajrit janë caktuar dhe dakorduar 10 lokacione për vendosjen e stacioneve monitoruese të cilësisë së ajrit. Në funksion janë tri pika të monitorimit të cilësisë së ajrit dhe për katër pika tjera është ndërtuar bazamenti për vendosjen e stacioneve.

Më 11.07.2011 është mbajtur trajnimi për 30 inspektor të profileve të ndryshëm të nivelit lokal dhe qendrorë për mbrojtjen e mjedisit.

#### **3.2.4. Politikat e Transportit**

Në kuadër të fuqizimit të legjislacionit sekondar janë miratuar UA si me poshtë:

- UA Nr. 3/2011 për Licencimin e Operatoreve te Transportit Rrugor te Mallrave (numri Protokollit 2296 data 19.08.2011);
- UA Nr. 2/2011 për Rrjetin e Linjave dhe Rendin e Udhëtimit te Transportit Nder - urban te Udhëtarëve me Autobus ( numri Protokollit 2295 data 19.08.2011);

- UA Nr.. 4/2011 për vendosjen formën ngjyrën dimensionet e shenjave dhe sinjalizimet e pajisjeve në komunikacionin rrugor, është nënshkruar më 23.08.2011.

Sa i përket implementimit të projektit të R7, ka përfunduar projekti zbatues për segmentet 1-3, po ashtu ka përfunduar draft projekti zbatues për segmentet 4-5. Për më tepër projekti preliminar për segmentin 7 ka përfunduar ndërsa kanë filluar punimet në projektin zbatues për segmentet 8-9. Për më shumë punimet në R7 janë realizuar si në vijim: Segmenti 1-3 Vermice - Prizren - Suharekë 76% Segmenti 4 Suharekë - Dule 22,90%.

Sa i përket marrëveshjeve ndërkombëtare në transportimin e pasagjerëve dhe të mirave, MI ka nënshkruar marrëveshje me Kroacinë (24.08.2011).

Në vazhden e implementimit të ligjit mbi transportin e mallrave të rrezikshme, janë licencuar 6 operator ndërsa në total janë të licencuar 74 operator. Sa i përket vendosjes së linjave të rregullta në transportin e rregullt të udhëtarëve me autobus me vendet e rajonit dhe me gjere janë lëshuar 26 leje operatorëve vendor dhe 22 leje operatorëve të huaj për operim në Kosovë.

Në kuadër të përpjekjeve të vazhdueshme për përmirësimin e kualitetit të rrjetit ekzistues të transportit rrugor ndërrurban gjatë këtij viti janë lëshuar 20 licenca (320 gjithsejtë), po ashtu janë dhenë gjithsejtë 1,271 autorizime për operim në transportin e brendshëm të udhëtarëve si dhe janë ndarë në total 141 Linja (Slote) në transportin e brendshëm të udhëtarëve. Ndërkaq sa i përket subvencionimit të transportit i cili është ekonomikisht i paqëndrueshëm por i domosdoshëm për të funksionuar janë nënshkruar 16 kontrata me 13 operatorë, përfshirë 22 sllote në 32 relacione.

Sa i përket aktiviteteve të inspektoratit të transportit rrugor, gjate kësaj periudhe janë ndërmarr 18 inicime për marrjen e lejeve ndërkombëtare, 120 përjashtime nga komunikacioni rrugor të kompanive transportuese të udhëtarëve dhe mallrave në mungesë të dokumentacionit përkatës si dhe në të njëjtën kohe janë shtyre kompanitë që të pajisen me licenca pune.

Në kuadër të procesit të ndarjes së hekurudhave të Kosovës, Qeveria ka miratuar vendimin nr. 04/24 të datës 20.07.2011 për themelimin e dy bordeve të drejtorëve të INFRAKOS dhe TRAINKOS. Projektligji mbi hekurudhat e Kosovës është miratuar në Qeveri. ËBIF do të financoj projektin e studimit të fizibilitetit të linjës hekurudhore lindje-perëndim.

Sa i përket përmirësimit të mënyrës së aftësimit dhe testimit të kandidatëve janë pranuar 250 kandidat dhe rezultatet janë si me poshtë:

- Testin teorik e kanë kaluar 187 kandidat (74,8%)
- Testin teorik dhe praktik e kanë kaluar 173 kandidat (69,2%)

Ndërsa aftësimin për shofer instruktor e kanë ndjekë 86 kandidat dhe rezultate janë si me poshtë:

- Janë licencuar 24 pyetës (examiner).
- Janë licencuar 51 shofer instruktor të rinj.

Në kuadër të aplikimit të metodave të reja në testin e kandidateve për shofer është bërë caktimi i linjave (rutave) për shtatë njësitë testuese: Prishtinë - 5 linja (ruta), Mitrovicë - 3 linja (ruta), Pejë - 3 linja (ruta), Gjakovë - 4 linja (ruta), Prizren - 3 linja (ruta), Ferizaj - 3 linja (ruta), Gjilan - 3 linja (ruta) kurse 10 % e testit teorik janë pyetje nga ECO – ngasja.

Në kuadër të zbatimit të programit të mirëmbajtjes dhe rehabilitimit të rrjetit rrugor punimet në tersi janë përfunduar 30 km rrugë, ndërkaq në segmente përkatëse janë punimet janë duke rrjedhur si në vijim:

- Segmenti M9 Sllatinë - Gjurgjicë - realizimi i përgjithshëm i projektit është 83 %. Objektet 85%.
- Segmenti M2 Shkabaj - Milloshevë, realizimi i përgjithshëm i projektit është 81%.

Sa i përket inventarizimit të rrugëve të reja (gjerësia, gjatësia e rrugës, bankinat, kanalet anësore, lëshesat, urat, muret mbrojtëse, rigollat) deri tani janë inventarizuar rrugët si në vijim: Nerodime-Jezerc R206, Tuxhevc- Kufi R216, Studenqan-Opterush R117, Glllogjan-Zajm R121, Kerpime-Kaqandoll R129, Prishtinë-Arllat M9, Prishtinë-Milloshevë M2, Prishtinë-QMI M2.

Në frymën e ngritjes së kapaciteteve institucionale për planifikimin e transportit multimodal, njësi për planifikim të transportit multimodal i është bashkangjitur Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinimit të Politikave. Trajnimet deritanishme të realizuara nëpërmes Konsulencës EGIS International IPA Program):

- Visum Modelim 50%;
- HDM4 30%;
- Multimodal Transport 30%;
- Planifikim Transporti 20%.

Sa i përket trajnimeve në fushën profesionale në fushën e transportit rrugor të udhëtareve dhe mallrave, gjatë kësaj periudhe kohore janë trajnuar dhe certifikuar 161 menaxher ndërkaq në lidhje me trajnimet në fushën e transportit të mallrave të rrezikshme janë trajnuar dhe certifikuar 55 shofer (gjithsej janë të trajnuar 810). Po ashtu ka përfunduar shkollimi dhe trajnimin i 20 punonjësve të ri në hekurudha. Ndërsa deri me tani ka përfunduar 60% e punës së planifikuar në adhurimin dhe rifreskimin e STMM.

**Aeroporti Ndërkombëtarë i Prishtinës (ANP)** - Vendim që Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës Adem Jashari të kategorizohet si aeroport me skemë lehtësuese ka filluar të implemetohet nga 1 qershori 2011 dhe për këtë janë informuar të gjithat palët e interesit.

### 3.2.5. Energjia

Me 22 korrik 2011, Ligji për Eficiencë të Energjisë është miratuar nga Kuvendi i Kosovës, dhe ka hyrë në fuqi pas nënshkrimit nga Presidentja e Republikës së Kosovës.

Projekti i Kogjenerimit Termokos – TC Kosova B – Studimi i fizibilitetit të këtij projekti ka përfunduar dhe dorëzuar në MZHE me datë 22 qershor 2011. Memorandumi i Mirëkuptimit është nënshkruar me 29 Qershor në mes palëve: MZHE, MF, Kuvendi Komunal i Prishtinës, Termokos dhe KfË.

Bordi i Zyrës së rregullatorit të Energjisë (ZRrE) më 30 mars ka miratuar Feed-in për energjinë e prodhuar nga Era, Uji dhe Biogasi/Biomasa.

**KOSTT sh.a** më tutje, KOSTT është në përfundim të implementimit të projekteve, siç është Paket Projekti 400/110 kV Ferizaj 2.

Lidhur me sigurimin me furnizim me energji, nga miniera e Sibovcit Jug-Perëndimor KEK sh.a gjatë periudhës raportuese ka kryer këto aktivitete: largimin e 2,010,000 m<sup>3</sup> djerrinë, prodhimin e 1,603,961 ton qymyr për TC Kosova A dhe B, riparuar ekskavatorin për djerrinë E5M dhe atë për qymyr E6B, si dhe është në përfundim riparimi i ekskavatori i qymyrit E7M dhe shiritave vetëlëvizës. Sa i përket përmirësimit të matjeve të energjisë elektrike, tek konsumatorët shtëpiak KEK-u ka instaluar 8411 copë, nga 10.000 të planifikuara për këtë vit.

### **3.2.6 Shoqëria Informative dhe Media**

**Auoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit (ART)** në kuadër të përpjekjeve për miratimin e rregulloreve për krijimin e kushteve për konkurrencë efektive në treg, ART ka miratuar rregulloren për interkoneksion (vendimi Nr.102 ref. ART nr. Prot. 032/B/11, 02 qershor 2011). Sa i përket ngritjes së numrit të stafit profesionale në ART është punësuar Menaxheri për cc TLD si dhe Menaxheri për KOSIX. Sa i përket promovimit të Njës shkëmbyese e internetit (KOSIX), kjo nyje është funksionalizuar me datë 22 qershor 2011.

### **3.2.7. Kontrolli Financiar**

Në kuadër të zbatimit të menaxhimit financiar MF ka aprovuar këto rregulla financiare:

- Rregulla Financiare 04/2011 - Raportimi i obligimeve të pa paguara, me datë 16.05.2011;
- Rregulla Financiare 05/2011- Raporti vjetor i organizatave buxhetore me datë 08.07.2011;
- Rregulla Financiare 06/2011- Raportimi Nëntë Mujor i Organizatave Buxhetore me datë 13.07.2011.

Në qershor të këtij viti Kuvendi i Kosovës ka aprovuar Raportin Vjetor për funksionimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik për vitin 2010.

Në kuadër të përmirësimit të menaxhimit të aseteve publike, duke nxitur projektet PPP, deri me 31.08.2011 lista e projekteve përmban gjithsej 22 projekte,5 nga këto janë në nivelin qendror dhe 17 në nivelin lokal

Këshilli Ndërministror për PPP gjatë periudhës raportuese ka aprovuar dy direktiva. Direktiva Nr.1/2011, Mbi procedurat për shqyrtimin dhe aprovimin e projekteve PPP dhe Direktiva Nr.2/2011 për Ekipet për Menaxhimin e Projekteve. Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur 10 seminare në nivelin qendror dhe atë lokale, për promovimin e PPP.

Në kuadër të ngritjeve të kapaciteteve njerëzore ka përfunduar faza e parë e Programit për trajnim dhe çertifikim ndërkombëtar. Trajnimi është organizuar nga CIPFA e Britanisë së Madhe dhe CEF – Slloveni. Prej 54 auditorëve të brendshëm 32 kanë përfunduar me sukses Programin. Gjithashtu prej 25-29 korrik janë trajnuar 12 tutor për



të vazhduar programin e Çertifikimit nga ekspert të CIPFA-së. Po ashtu, në kuadër të ngritjes së kapaciteteve njerëzore, gjate muajit korrik janë rekrutuar 10 auditorë të rinj. Gjate kësaj periudhe raportuese janë përfshirë 7 persona si studente ne Shoqata e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Certifikuar. SHKACK. Po ashtu janë rekrutuar 2 zyrtare në ACCA. Gjat kësaj periudhe janë mbajtur 928 ore trajnime.

Zyra e Auditorit Gjeneral në periudhën 2010/11 ka publikuar 87 raporte të auditimi. Raporti Vjetor i Auditimit publikohet me 31 Gusht i cili bazohet ne 86 raporte të auditimit: 81 janë auditime të rregullsisë; 4 auditime menaxheriale dhe 1 auditim i përfomances; gjatë kësaj kohe raportuese janë kryer 34 kontrolle shëndetësore. Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur 16 dëgjime publike ne Kuvend respektivisht KMFP.

### 3.2.8. Statistikat

Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave është kryer me sukses prej datës 01 deri me 15 prill. Në disa komuna regjistrimi ka vazhduar deri më 19 prill 2011. Anketa Pas Regjistrimit është kryer në mes të 16 dhe 22 prill 2011, Rezultatet preliminare të regjistrimit të popullsisë janë publikuar më 29 Qershor 2011.

Mes 1 majit dhe 31 gushtit 2011 janë publikuar këto raporte periodike:

**Raporte Mujore:** “Indeksi i Cmimit të konsumit” për periudhën prill-korrik; “Statistikat e Tregtisë së Jashtme” për periudhën prill-korrik;

**Raporte Kuartale:** “Indeksi i Cmimit të Importit” i kuartalit të parë i publikuar më 4 korrik 2011; “Indeksi i Cmimit të Prodhimit” i kuartalit të parë publikuar më 6 korrik 2011; “Statistikat e Hotelarisë dhe Turizmit” i kuartalit të parë publikuar më 28 qershor 2011; “Balanci i Energjisë në Kosovë” i kuartalit të parë publikuar më 29 qershor 2011; “Repertoari i Statistikave të Ndërrmarjeve në Kosovë” i kuartalit të parë publikuar më 16 maj 2011 dhe i kuartalit të dytë i publikuar më 11 gusht 2011; “Indeksi i Cmimit të Prodhimeve Agrokulturore” i kuartalit të parë publikuar në maj 2011 dhe i kuartalit të dytë i publikuar në gusht 2011; “Buletini Kuartal” për kuartalin e parë i publikuar në maj 2011 dhe për të dytin në gusht 2011.

**Raporte Vjetore:** “Indeksi i Cmimit të Konsumit” për vitin 2010 i publikuar më 28 qershor 2011; “Statistikat e Tregtisë së Jashtme” për vitin 2010 i publikuar më 1 korrik 2011; “Indeksi i Vlerës së Njësive të Importit dhe Eksportit” për vitin 2010 i publikuar më 1 korrik 2011; “Indeksi i Poridhimeve Agrokulturore 2005-2010” i publikuar në qershor 2010; “Indeksi i Cmimit në Agrikultur 2005-2010” publikuar në qershor 2010; “Varfëria në Kosovë 2009” publikuar në maj 2011; “Statistikat e Divorcit në Kosovë” publikuar në qershor 2010; “Statistikat e Mortalitetit në Kosovë” publikuar në qershor 2011; “Shkaqet e Mortalitetit në Kosovë 2008-2009” publikuar në gusht 2011; “Statistikat e Fertilitetit në Kosovë” për vitin 2010 publikuar në gusht 2011; “Kosova në Shifra” për vitin 2010 publikuar në qershor 2011.

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve institucionale në fushën e statistikave, gjatë muajit korrik, është trajnuar një person nga programi IPA 2008 për regjistër të biznesit.

## 3.3. DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA

### 3.3.1. Vizat, kufijtë, azili dhe migrimi

Sa i përket kornizës ligjore dhe të politikave në fushën e Menaxhimit të Integruar të Kufirit, gjatë periudhës raportuese kanë hyrë në fuqi këto akte dhe dokumente:

- PSO për Aksionet e Përbashkëta (më 20 korrik 2011);

- PSO Qendrën Nacionale për Kontrollin e Kufijve dhe Përdorimin e Përbashkët të Pajisjeve (më 20 korrik 2011);
- PSO për Qendrën Kombëtare Nacionale të Kontrollit të Përbashkët të Kufirit (më 20 korrik 2011);
- PSO për Shfrytëzimin e Përbashkët të Pajisjeve (më 20 korrik 2011);
- PSO për Aktivitete të Përbashkëta (më 20 korrik 2011); dhe
- Manuali i Komunikimit (më 6 qershor 2011); dhe
- Shtojca e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Policisë së Kosovës dhe Doganës së Kosovës (pjesë integrale e MM trepalësh, PK-DK-ATK, të nënshkruar më 22 tetor 2009) (më 18 maj 2011).

Më 1 prill 2011 ka hyrë në fuqi Marrëveshja e Mirëkuptimit në mes të MPB-së së Kosovës, dhe është finalizuar dhe pritet të hyjë në fuqi së shpejti e njëjta lloj marrëveshjeje me palën maqedonase për hapjen e pikës së re të kalimit të kufirit në Stançiq. Më 30 prill 2011 kanë hyrë në fuqi Marrëveshjet e Mirëkuptimit në mes të MPB-së së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë për kontrollin e përbashkët kufitar në PKK Vërmicë, Qafa e Prushit dhe Qafa e Morinës.

Sa i përket avancimit të kapaciteteve institucionale dhe teknike në fushën e MIK-ut, gjatë periudhës raportuese është shënuar përparim i rëndësishëm në zhvillimin e sistemit të TI-së. Më 5 gusht 2011 është vënë në funksion BMS (Sistemi i Menaxhimit të Kufirit) në të gjitha pikat e kalimit kufitar, përfshirë Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, gjë që ka përmirësuar rrjedhën e informatave për qëllime të hetimeve penale, por gjithashtu edhe kapacitetet për analizimin e tyre me qëllim të luftimit të krimin të organizuar. Më tej, më 8 gusht 2011 ka filluar studimi i fizibilitetit për instalimin e Sistemit Informativ të Policisë së Kosovës (KPIS), i cili do të mundësojë integrimin e të gjitha sistemeve ekzistuese të TI-së në një të vetëm. Sipas planeve të dakorduara me donatorin (KE), ky sistem të fillojë të instalohet në fund të shtatorit 2011. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë ngritur kapacitetet për kontroll dhe mbikëqyrje të kufirit përmes furnizimit me pajisje teknike, donacion nga ana e KE-së, ICITAP-it dhe EXBS- së.

Me qëllim të kompletimit dhe avancimit të kornizës ligjore dhe të politikave në fushën e ri-pranimit dhe ri-integrimit të personave të riatdhesuar, gjatë periudhës raportuese janë nënshkruar këto marrëveshje bilaterale të ripranimit:

- Marrëveshja e Ripranimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Sllovenisë (nënshkruar më 10 maj 2011);
- Marrëveshja e Ripranimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe shteteve të Beneluksit (Belgjikë, Holandë dhe Luksemburg) (nënshkruar më 12 maj 2011 dhe ratifikuar më 11 korrik 2011);
- Marrëveshja e Ripranimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Çekisë (nënshkruar më 24 qershor 2011);
- Marrëveshja e Ripranimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Malit të Zi (nënshkruar më 30 qershor 2011).

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve institucionale dhe përmirësimit të koordinimit e bashkëpunimit ndër-institucional në këtë fushë, janë zhvilluar 4 Takime pune, si në nivelin politik ashtu edhe atë teknik. Në fokus të këtyre takimeve ka qenë rëndësia e ri-

integritit të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar për procesin e liberalizimit të vizave, përmirësimin e koordinimit ndër-institucional dhe të kapaciteteve për koordinim, implementim dhe raportim në nivelin komunal, si dhe rolin ndihmës dhe lehtësues që mund të ofrojnë institucionet e nivelit qendror. Përveç kësaj, edhe vizitat e Ministres së Integritit Evropian në të gjitha Komunitatet e vendit (gjatë muajve qershor – korrik 2011) kanë kontribuar që ri-integrimi i personave të riatdhesuar të bëhet realisht prioritet në të dyja nivelet e qeverisjes. 15 shërbyes civil të nivelit qendror janë certifikuar si ToT në qështjet që lidhen me riintegrim dhe trajnim lidhur me procedurat dhe politikën e riintegritit u është ofruar 160 zyrtarëve komunal (Zyrtarëve Komunal për Komunitet dhe Kthim, Zyrtarëve Komunal për Cështje Evropiane, Drejtorëve të Administratës, Regjistrin Civil, Edukim dhe Mirëqenie Sociale). Seancat e trajnimit janë mbajtur në Prishtinë me fokusin në procedurat për aplikim në Fondin e Riintegritit për mbështetje të riatdhesuarve. Gjithashtu, ku është paraqitur nevoja, janë mbajtur trajnime zyrtarëve komunal gjat misionit vlerësues gjatë gushtit 2011.

Në nivelin e implementimit, gjatë periudhës raportuese Zyra e MPB-së për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Zyra Pritëse në Aeroport kanë intensifikuar punën e tyre në koordinimin dhe menaxhimin e procesit të riatdhesimit në nivelin teknik, përmes shkëmbimit të rregullt të informatave mbi personat e riatdhesuar me Ministrinë dhe Komunitatet. Sa i përket nivelit komunal, ata kanë vijuar të punojnë ngushtë me Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe me drejtoritë relevante komunale, në veçanti për të siguruar pritjen e këtyre personave në mënyrë adekuate, informimin e tyre mbi shërbimet publike në dispozicion dhe dorëzimin e kërkesave për ndihmë nga burimet e Programit/Fondit të Qeverisë së Kosovës për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar. Gjithashtu këto struktura komunale janë informuar rregullisht mbi politikën, Strategjinë dhe PV për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar dhe procedurat përkatëse, pastaj në plotësimin e kërkesave për ndihmë nga Fondi në përputhje me kriteret përkatëse, por edhe në monitorimin dhe sigurimin e zbatimit të vendimeve përkatëse të Bordit Ekzekutiv.

Në anën tjetër, Zyra Pritëse në Aeroport ka vijuar me regjistrimin e personave të riatdhesuar dhe identifikimin e nevojave të tyre dhe adresimin e këtyre çështjeve të institucionet përkatëse qendrore dhe lokale, duke i kushtuar kujdes të veçantë grupeve të cenueshme, siç kërkohet përmes Strategjisë dhe PV për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar dhe me kriteret për përfitim nga Fondi (siç janë pjesëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas, nënat vetushqyese, fëmijët, fëmijët pa përkujdesje, të moshuarit dhe ata me nevojë të veçanta). Në këto raste, menjëherë janë njoftuar institucionet përkatëse dhe Komunitatet e origjinës ose të destinacionit të tyre, dhe atyre u janë ofruar zgjidhje të përshtatshme.

Me qëllim të vlerësimit të zbatimit të legjislacionit dhe politikave për ri-integrimin e personave të riatdhesuar nga ana e strukturave komunale (gjatë periudhës janar 2010 – qershor 2011), si dhe të kapaciteteve institucionale të tyre, në fillim të gushtit janë formuar 5 ekipe ndërministrorë ekspertësh në fushën e ri-integritit, të cilët deri në mesin e gushtit kanë përfunduar vizitat vlerësuese në secilën Komunë. Gjatë këtyre vizitave, ata kanë bërë vlerësimin e implementimit të kësaj strategjie, gjithashtu u kanë ofruar Komunave këshilla profesionale dhe ekspertizë për zbatimin e strategjisë në nivelin komunal, gjë që njëkohësisht ka shërbyer si ushtrim për ngritjen e mëtejme të kapaciteteve të zyrtarëve të Zyrave Komunale për Komunitete dhe Kthim (me rol

koordinues sa i përket ri-integrimit të personave të riatdhesuar) dhe të drejtorive sektoriale përgjegjëse për regjistrim civil e gjendjen civile, arsimim, shërbime sociale, të punësimit e të trajnimeve profesionale, shërbime shëndetësore, dhe çështje pronësore e të strehimit. Raporti vlerësues i dalë nga ky proces mbi implementimin e Strategjisë dhe PV për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar, i cili do të mbulojë secilën Komunë, pritet të finalizohet në fund të gushtit 2011.

Në fushën e azilit dhe të huajve, gjatë periudhës raportuese fletëpalosja informuese, e finalizuar në nëntor 2010: totali i 6,000 kopjeve, në 6 gjuhë (Shqipe, Serbe, Angleze, Arabe, Persiane dhe Frënge) është shpërndarë më 30 nëntor 2010, dhe më 3 gusht 2011, 4,000 palosje janë shpërndarë edhe në tri gjuhë tjera: Italiane, Turke dhe Spanjolle (700 ne gj. Arabe, 700 në gj. Persiane, 500 në gj. Angleze, 300 në gj. Shqipe, 300 në gj. Frënge, 300 në gj. Serbe, 500 në gj. Turke, 350 në gj. Spanjolle, dhe 350 në gj. Italiane). Prej këtyre 1,500 fletushka janë shpërndarë nga Qendra e Azil-Kërkuesve, 1,500 nga DMK/PK dhe 1,000 duhet të shpërndahen nga UNHCR dhe CRP/K.

Me qëllim të kompletimit dhe avancimit të kornizës ligjore dhe të politikave në fushën e regjistrave civilë dhe sigurisë së dokumenteve, më 23 qershor Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin e plotësuar-ndryshuar për Gjendjen Civile. Në nivelin e politikave, gjatë kësaj periudhe është miratuar Plani Strategjik i Punës i Agjencisë së Regjistrimit Civil 2011 - 2015. Sa i përket ngritjes së kapaciteteve institucionale në fushën e regjistrave civilë dhe sigurisë së dokumenteve, gjatë periudhës raportuese është themeluar dhe funksionalizuar Qendra Komunale e Regjistrimit Civil në Kllokot.

Sa i përket implementimit në terren, projekti i filluar në tetor 2010 për skanimin dhe digjitalizimin e Librave Amëz të Lindjes, Martesës dhe Vdekjes ka përfunduar më 18 korrik 2011. Gjatë këtij procesi janë skanuar dhe digjitalizuar të gjitha librat amëz që gjenden në Kosovë, pra gjithsej 14,130 prej tyre, të cilët përfshijnë periudhën kohore 1900 - 2011. Gjithashtu, më 20 qershor 2011, Ministria e Punëve të Brendshme ka nënshkruar kontratën për prodhimin e pasaportave biometrike me kompaninë austriake OESD. Më 4 korrik 2011 në Vjenë është mbajtur procedura e fillimit të lëshimit të Pasaportave Biometrike (kur është lëshuar edhe kopja testuese - specien), ndërsa nga tetori 2011 pritet të fillojë personalizimi dhe lëshimi i Pasaportave.

### **3.3.2. Pastrimi i Parave**

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve institucionale për parandalimin dhe luftimin e krimeve financiare, Njësia e Inteligjencës Financiare në kuadër të MF deri më tani ka rekrutuar 15 nga gjithsej 16 zyrtarë të planifikuar.

